



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.06.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 24.04.2020, 27.04.2020, 28.04.2020, 05.05.2020 dhe 06.05.2020.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 17:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

#### **RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 24.04.2020, 27.04.2020, 28.04.2020, 05.05.2020 dhe 06.05.2020.

**Naureda Llagami:** Përshëndetje të gjithëve!

Po fillojmë mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 11 qershor 2020. Të pranishëm në këtë mbledhje janë të gjithë anëtarët e KLGJ-së, përveç zotit Dritan Hallunaj, i cili për arsye shëndetësore e ka të pamundur që të jetë në këtë mbledhje.

Atëherë, siç jeni vënë në dijeni me rendin e ditës, Këshilli sot do të marrë për shqyrtim 11 çështje, konkretisht:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 24.04.2020, 27.04.2020, 28.04.2020, 05.05.2020 dhe 06.05.2020.

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”.

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”.

4. Shqyrtimi i relacionit mbi dhënien e komenteve dhe kundërshtimeve për raportin e Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidateve

që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2020-2021, profili gjyqtar”.

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”.

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.83, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr.86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”.

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”.

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarës {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

11. Vijimi i shqyrtimit të çështjes në lidhje me problematikën e adresuar nga Presidenti i Republikës me Shkresën nr.1117/2 prot., datë 10.04.2020, lidhur me qëndrimin e mëtejshëm në detyrë të z. {...} si anëtar i Gjykatës së Lartë.

Atëherë, kalojmë në shqyrtimin e çështjeve (nëse nuk kemi gjë) sipas rendit të ditës.

Çështja e parë ka të bëjë me miratimin e procesverbaleve.

Procesverbalet, siç jeni vënë në dijeni, janë shpërndarë nga stafi.

Keni pasur mundësi që të reflektoni komentet dhe sugjerimet tuaja.

Nëse nuk keni diskutime, unë do propozoja hedhjen në votim të procesverbaleve.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Dakord.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 24.04.2020, 27.04.2020, 28.04.2020, 05.05.2020 dhe 06.05.2020. 2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.06.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 17:41.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Illir Toska* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

## **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Për më shumë sqarime, i jap fjalën relatores, znj. Ukperaj.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Në vijim të punës për plotësimin e Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve, ju paraqitet sot për miratim në Mbledhje Plenare, projektvendimi “Për miratimin e “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, e cila është pjesë përbërëse e Skemës së Vlerësimit dhe ka për qëllim përcaktimin e rregullave të përzgjedhjes së çështjeve me short, procedurën e zhvillimit dhe dokumentimit të shortit për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim, në zbatim të nenit 91 të Ligji për Statusin dhe Vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”.

Dosjet e përzgjedhura me short përcaktohen në ligj si një nga burimet e vlerësimit. Neni 91 i Ligjit për Statusin ka parashikuar disa parime mbi të cilat duhet të bëhet përzgjedhja me short e çështjeve për vlerësim. Këto parime zërthehen në këtë projekt-akt në rregulla të posaçme që disiplinojnë jo vetëm procedurën e përzgjedhjes me short të çështjeve, por detajojnë edhe kriteret mbi të cilat relatori përcakton numrin dhe kategorinë e çështjeve që duhet të përzgjidhen. Përzgjedhja është gjithëpërfshirëse, rastësore dhe transparente.

Projekt-akti është organizuar në pesë grupe rregullash të cilat përfshijnë parimet e përgjithshme të përzgjedhjes së çështjeve me short, kriteret në bazë të së cilave përcaktohet numri dhe kategoritë e çështjeve mbi të cilat do të bëhet përzgjedhja, rregullat procedurale të zhvillimit të shortit, rregullat për dokumentimin e shortit dhe vëzhgimin e dosjeve si dhe dispozita kalimtare lidhur me zbatimin e rregullave të përzgjedhjes së çështjeve për procedurën e gradimit të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar.

Në Kreun I të projekt-aktit, pika 1 deri në pikën 9, janë parashikuar parimet e përgjithshme për përzgjedhjen e çështjeve me short, duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar.

Në pikën 1, 2 dhe 3 të projekt-aktit është përcaktuar se përzgjedhja e çështjeve me short, bëhet pas fillimit të procedurës së vlerësimit dhe është pjesë e kësaj procedure. Ajo kryhet nëpërmjet shortit elektronik kur është e mundur dhe zhvillohet në mjediset e gjykatës ku gjyqtari ka ushtruar më gjatë detyrën gjatë periudhës së vlerësimit, në përputhje me nenin 91, pika 6 dhe 7 të Ligjit për Statusin.

Në pikën 4 të projekt-aktit është parashikuar se përzgjedhja e çështjeve për vlerësim bëhet në mënyrë rastësore dhe nëpërmjet një procesi transparent. Gjithashtu në këtë pikë janë përcaktuar subjektet që marrin pjesë në mënyrë të domosdoshme në procesin e shortit dhe subjektet, pjesëmarrja e të cilëve është jo e domosdoshme.

Konkretisht parashikohet se duhet të marrin pjesë nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, i cili është edhe personi përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e rregullt të shortit; kancelari i gjykatës si subjekti që kujdeset për mbarëvajtjen e procesit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin normal të tij; një sekretare gjyqësore e cila do të kujdeset për verifikimin e çështjeve të përzgjedhura me short në sistemin e menaxhimit të

çështjeve dhe mbajtjen e procesverbalit për dokumentimin e procedurës së shortit dhe; punonjësi i IT-së i gjykatës që do të garantojë asistencë teknike gjatë procedurës. Ndërkohë, parashikohet pjesëmarrja jo e detyrueshme e gjyqtarit subjekt vlerësimi, e çdo anëtari të KVEVP si dhe një punonjësi i IT-së së KLGJ-së, për të asistuar nëse do të jetë e nevojshme për procedurën e zhvillimit elektronik të shortit.

Në pikën 5 dhe 6 parashikohet detyrimi i kancelarit dhe kryetarit të gjykatës për të krijuar kushtet për zhvillimin e rregullt të procedurës së shortit, në ndihmë të nëpunësit përgjegjës për vlerësimin. Për këtë qëllim parashikohet njoftimi i datës dhe orës së zhvillimit të shortit për këto dy subjekte të paktën dy ditë para zhvillimit të tij.

Në pikat 7, 8 dhe 9 parashikohen rregulla të përgjithshme që duhet të ndiqen nga relatori për përcaktimin e numrit të çështjeve që do të përzgjidhen me short për secilin vit vlerësimi, me qëllim vlerësimin e të gjithë punës së gjyqtarit në periudhën përkatëse, si në aspektin e shtrirjes kohore ashtu edhe në lidhje me kategoritë e çështjeve të gjykuara, uljen e numrit të çështjeve në mënyrë proporcionale në rast të mosushtimit të detyrës nga gjyqtari për më tepër se 6 muaj gjatë periudhës së vlerësimit si dhe përfshirjen në short të të gjitha çështjeve në të cilat gjyqtari ka qenë relator gjatë periudhës së vlerësimit, jo vetëm atyre të përfunduara në gjykatën ku ai ushtron funksionin, por edhe çështjeve të gjykuara në gjykata të tjera ku është transferuar ose caktuar për çështje të veçanta.

Në Kreun e II-të të projekt-aktit janë përcaktuar gjashtë kriteret mbi të cilat relatori përcakton numrin dhe kategoritë e çështjeve që do të përzgjidhen me short. Këto kritere duhet të ndiqen nga relatori në momentin që ai merr vendim për zhvillimin e procedurës së shortit duke përcaktuar numrin dhe kategoritë e çështjeve që duhet të përzgjidhen, sipas parashikimeve të nenit 91, pika 2 të Ligjit për Statusin.

Konkretisht në pikën 10/a parashikohet kriteri vjetor sipas të cilit relatori duhet të përzgjedhë një numër të përcaktuar çështjesh për çdo vit, referuar periudhës së vlerësimit (5, 3 ose 1-vjeçare).

Në pikën 10/b parashikohet kriteri i vonesës në afate i cili është përcaktuar shprehimisht nga neni 91, pika 1 e Ligjit për Statusin. Sipas këtij kriteri 5% e dosjeve por jo më shumë se 6 çështje, duhet të përzgjidhen nga lista e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor ose standardit minimal kohor.



Pas përcaktimit të numrit të çështjeve sipas kriterit vjetor dhe atij të vonesës në afate, vijohet me përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e dosjeve për vlerësim të përgjithshëm, sipas kategorive, duke përcaktuar kriteret e përzgjedhjes si më poshtë:

Në pikën 11/a parashikohet kriteri gjithëpërfshirës sipas të cilit, çështjet duhet të përzgjidhen duke përfshirë në short të gjitha çështjet e gjykuara nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, në gjykatën ku ai ushtron funksionin si dhe në gjykata të tjera ku mund të ketë qenë i transferuar apo caktuar përkohësisht për gjykimin e çështjeve të veçanta. Për këtë qëllim parashikohet përfshirja në një tabelë të vetme të çështjeve të së njëjtës kategori për secilin vit vlerësimi, në rastet kur gjyqtari ka gjykuar edhe në gjykata të tjera me qëllim që të përfshihen në short të gjitha çështjet e gjykuara nga gjyqtari në periudhën e vlerësimit.

Në pikën 11/b parashikohet kriteri i barazisë në përzgjedhje sipas të cilit relatori, në përcaktimin e numrit të çështjeve që do të përzgjidhen për çdo kategori, i referohet raportit të numrit të çështjeve për secilën kategori në numrin e përgjithshëm të çështjeve të gjykuara nga gjyqtari.

Në pikën 11/c parashikohet kriteri i natyrës së vendimit sipas të cilit, në çështjet e përzgjedhura për vlerësim të përgjithshëm, numri i çështjeve të cilat janë përfunduar me vendim jopërfundimtar (kthim aktesh, pushim, mospranim etj.) nuk duhet të kalojë më shumë se 10% të numrit të çështjeve të përzgjedhura. Ky kufizim përcaktohet në nenin 91, pika 4 të Ligjit për Statusin dhe ka për qëllim shmangien e përzgjedhjes rastësore nga shorti të një numri tejet të lartë çështjesh të cilat janë përfunduar me vendim jopërfundimtar (përkufizimin e ka bërë vetë Ligji për Statusin, neni 2/n), me qëllim përzgjedhjen e dosjeve që ofrojnë material të mjaftueshëm për vlerësimin e aftësive profesionale të gjyqtarit.

Në pikën 11/ç parashikohet kriteri i kompleksitetit të çështjes sipas të cilit relatori përcakton numrin e çështjeve pa palë kundërshtare si kategori më vete që mund të përzgjidhen me short, në raport me numrin e përgjithshëm të çështjeve që do të përzgjidhen për vlerësim. Ky numër nuk duhet të kalojë më shumë se 20% të numrit të përgjithshëm të çështjeve që do të përzgjidhen për vlerësim, në referim të nenit 91, pika 5 të “Ligjit për Statusin”.

Respektimi i kriterëve ligjore në përcaktimin e numrit të çështjeve që do të përzgjidhen me short sipas parashikimeve të nenit 91 të “Ligjit për Statusin” dhe pikës 10 të këtij projekt-akti, sigurojnë gjithë përfshirjen në kohë dhe kategori çështjesh për të gjithë periudhën e vlerësimit të gjyqtarit, përzgjedhjen e çështjeve për çdo kategori dhe shmangien e përzgjedhjes të një numri të lartë çështjesh jo komplekse ose për të cilat është disponuar me vendim jo përfundimtar. Në këtë mënyrë garantohet një vlerësim sa më objektiv, real dhe i plotë i aftësive profesionale të gjyqtarit.

Në Kreun III janë përcaktuar rregullat e zhvillimit të shortit në gjykatë, pasi relatori ka marrë vendim për përcaktimin e numrit të çështjeve që do të përzgjidhen sipas kategorive dhe kriterëve të relatuara më lart.

Për këtë qëllim, në pikën 12, 13 dhe 14 të projekt-aktit është parashikuar se shorti zhvillohet bazuar në listën e plotë të çështjeve të gjykuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbi bazën e disa hapave të përcaktuara në projekt-akt dhe në vendimin e relatorit, referuar të dhënave statistikore pjesë e tabelave, që janë pjesë e tabelave tashmë të miratuara.

Në pikën 15 dhe 16 të projekt-aktit përcaktohen hapat e zhvillimit të shortit. Konkretisht shorti fillon me përzgjedhjen e çështjeve nga kategoria specifike e çështjeve të gjykuara jashtë afatit, sipas tabelës ndihmëse me të dhënat për çështjet me palë kundërshtarë të gjykuara jashtë afatit, të përgatitur nga nëpunësi përgjegjës. Më pas procedura vijon me përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim të përgjithshëm, sipas kategorive, referuar vendimit të relatorit, duke përjashtuar çështjet që janë përzgjedhur sipas kategorisë specifike të vonesës në afate.

Në pikën 17 të projekt-aktit është parashikuar procedura e verifikimit fizik të çështjeve që do të përzgjidhen në mënyrë rastësore nga shorti për t’u siguruar se ato përmbushin kushtet e përcaktuara në ligj, rregullat e shortit sipas projekt-aktit dhe vendimin e relatorit. Nëse shorti përzgjedh një çështje e cila, pas verifikimit, rezulton se nuk përmbush këto kushte (p.sh.: kur çështja është përzgjedhur më parë nga gjyqtari, ose tejkalohet numri i çështjeve që janë përfunduar me vendim jopërfundimtar) atëherë çështja e përzgjedhur nuk merret dhe vijohet me përzgjedhjen e një çështjeje tjetër nga e njëjta kategori.

Në pikën 18 të projekt-aktit parashikohet detyrimi për bashkëpunim mes gjykatave, me qëllim verifikimin e vendimeve të përzgjedhura me short, për çështjet që i përkasin një gjykate tjetër, të ndryshme nga ajo ku zhvillohet procedura e shortit. Për të mundësuar ecurinë normale në kohë sa më të shpejtë të shortit, është parashikuar komunikimi mes gjykatave në kohë reale me anë të postës elektronike.

Në kreun IV të projekt-aktit janë parashikuar rregullat për dokumentimin e shortit dhe vëzhgimin e dosjeve të përzgjedhura duke parashikuar në pikën 19 dhe 20 dokumentimin e procedurës së shortit në procesverbalin që do të mbahet nga një sekretare gjyqësore dhe nënshkrimin e tij nga të gjithë pjesëmarrësit, duke pasqyruar edhe vërejtjet që ata mund të kenë për procedurën e zhvillimit të shortit. Referuar nenit 13, pika 6 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, forma standarde e mbajtjes së procesverbalit në këtë rast, duhet të miratohet me vendim të Këshillit. Për shkak të natyrës që ka miratimi i këtij modeli, Komisioni ka vlerësuar që ky procesverbal si model standard, të mos jetë pjesë përbërëse (pra të mos jetë një aneks i veçantë) i këtyre rregullave me natyrë nënligjore normative, por do t’i propozohet për miratim Mbledhjes Plenare me një akt të veçantë.

Në pikën 21 të projekt-aktit parashikohet dorëzimi i një kopjeje të procesverbalit kancelarit të gjykatës me qëllim përgatitjen e dosjeve të përzgjedhura, një kopje gjyqtarit, ndërsa kopja origjinale bëhet pjesë e dosjes së vlerësimit. Marrja dijoni nga ana e gjyqtarit jo prezent është i rëndësishëm për gjithë procedurën e vlerësimit, pasi në kushtet kur procedura e shortit nuk varet nga dërgimi i akteve nga kryetari i gjykatës, mund të ekzistojë mundësia që gjyqtari të përzgjedhë për vlerësim të njëjtat vendime të përzgjedhura nga shorti.

Në pikën 22 dhe 23 parashikohen rregulla për procedurën e vëzhgimit të dosjeve të përzgjedhura dhe dërgimin e tyre pranë KLGJ-së, duke përcaktuar detyrat e kancelarit të gjykatës për marrjen e masave për fotokopjimin, njehsimin dhe dërgimin e tyre. Në rastet kur një ose disa nga dosjet e përzgjedhura nuk ndodhen në gjykatën ku zhvillohet shorti, por në një gjykatë tjetër, nëpunësi përgjegjës kërkon dërgimin e akteve nga gjykata përkatëse.

Në kreun V janë parashikuar dispozitat kalimtare për procedurën e shortit në procesin e gradimit të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Në pikën 24 të projekt-aktit parashikohet se për këtë proces do të përzgjidhen me short 6 dosje shtesë, në përputhje me parashikimet e nenit 21, pika 4 të Vendimit të nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”. Para zhvillimit të procedurës së shortit për përzgjedhjen e 6 dosjeve, nëpunësi përgjegjës evidenton dhe vë në dijeni relatorin për të gjitha çështjet që janë pjesë e dosjes së rivlerësimit të gjyqtarit, të përzgjedhura me short gjatë këtij procesi, të përzgjedhura për vlerësim nga vetë gjyqtari ose për shkak të verifikimit të ankesave gjatë procedurës së rivlerësimit, me qëllim shmangien e përzgjedhjes së tyre rishtazi me short.

Në pikën 25 të projekt-aktit parashikohet që 6 çështjet e përzgjedhura për këtë proces do të jenë çështje me palë kundërshtarë për të cilat është disponuar me vendim përfundimtar, duke shmangur pushimet, mospranimet, refuzimet, etj. Komisioni ka vlerësuar se, në kushtet kur vendimi i organeve të rivlerësimit, ka efekte vetëm për sa i përket arritjes së një niveli minimal kualifikues të gjyqtarit, për të përcaktuar shkallën ose nivelin e vlerësimit mbi atë minimal (mjaftueshëm, mirë, shumë mirë apo shkëlqyeshëm), është i nevojshëm përzgjedhja shtesë e çështjeve që kanë një shkallë me të lartë kompleksiteti dhe që kërkojnë analizë të dispozitave materiale.

Në pikën 26 parashikohet zbatimi gjatë procesit të gradimit, i të njëjtave rregullave për dokumentimin, vëzhgimin dhe dërgimin e dosjeve të përzgjedhura me short.

Bashkëlidhur projekt-aktit si Aneks I është formati tabelor (tabela ndihmëse), mbi të cilin nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, do të përgatisë tabelën për kategorinë e çështjeve për të cilat është vendosur jashtë afateve standarde.

Për sa më sipër, në pikën e parë të projekt-vendimit është parashikuar miratimi i rregullave për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, sipas tekstit bashkëlidhur.

Duke e konsideruar një akt administrativ normativ, pjesë e Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve, është parashikuar hyrja në fuqi e aktit në datën e botimit në Fletoren Zyrtare, në referim të parashikimeve të nenit 98, pika 4 të Ligjit nr.115/2016.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Do të ftoja kolegët nëse kanë komente, sugjerime lidhur me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit.

Nëse nuk keni, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.06.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 17:41.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Illir Toska* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Sërish ia jap fjalën zonjës Ukperaj.

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit, zonja Kryetare!

Në kundër të zbatimit të programit të vlerësimeve që kemi miratuar për vitin 2020, vjen propozimi i parë për mbledhjen plenare për të filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, pra gradimin e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.

Vijimi i kësaj procedure për këtë grup gjyqtarësh, për periudhën e rivlerësimit që përfshin vitet 2013-2016, është përgjegjësi e Këshillit të Lartë Gjyqësor sipas parashikimeve të nenit 147/1, shkronja “a” e Kushtetutës, si dhe në zbatim të nenit 171, pika 5 e “Ligjit për Statusin”, ku parashikohet se: “5. Pas vlerësimit të aftësive

profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelimit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës”.

Në referim të kuadrit ligjor si më sipër, Këshilli ka miratuar disa akte nënligjore që plotësojnë skemën e vlerësimit të gjyqtarëve. Lidhur me këtë proces, në vendimin nr. 263, datë 22.11.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor, në nenin 21, pika 1 dhe 2, ka parashikuar se periudha e vlerësimit kalimtar nga data 08.10.2013 deri në 08.10.2016 përbën periudhë të plotë vlerësimi periodik 3-vjeçar e cila përfundon me përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarin që ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë. Njëkohësisht, gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, është përcaktuar edhe si prioritet në “Programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” por njëkohësisht është përcaktuar tashmë edhe si një nga vlerësimet në rregulloren e ngritjes në detyrë.

Si burime vlerësimi në këtë rast shërbejnë aktet e vlerësimit profesional pjesë e dosjes së rivlerësimit dhe 6 dosje të tjera shtesë që përzgjidhen me short nga kjo periudhë vlerësimi sipas parashikimeve të akteve nënligjore të miratuara.

Referuar kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, procesi i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar fillon vetëm pas dërgimit në Këshill të dosjeve përkatëse nga organet e rivlerësimit. Aktualisht, nga organet e rivlerësimit kanë filluar pas muajit janar dërgimi i këtyre dosjeve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe sot pranë këtij Këshilli janë administruar dosjet e rivlerësimit për 18 gjyqtarë që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar.

Dua të sqaroj se aktualisht në sistem ka 27 gjyqtarë të konfirmuar me vendim të formës së prerë, 6 prej të cilëve janë aktualisht anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, 1



gjqqtar (z. {...}) që është aktualisht në Gjykatën e Lartë dhe 2 gjyqtarë të tjerë për të cilët nuk kanë mbërritur ende dosjet e rivlerësimit.

Për këtë arsye por edhe për shkak të asaj çka kemi miratuar në program, në vijim do të procedohet me fillimin e procesit të rivlerësimit për 18 dosjet/gjyqtarët që kanë ardhur mbi bazën e dosjeve të përcjella.

Në relacion janë përcaktuar konkretisht emrat e gjyqtarëve.

Nuk lexohen emrat pasi janë në mënyrë analitike, të parashikuara edhe datat kur për ta vendimi ka marrë formë të prerë (znj. {...} – z. {...}).

Për sa më lart, mbështetur në nenin 89, pika 1 dhe 171, pika 5 të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, nenin 63 dhe 86, shkronja “dh” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” si dhe “Programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020” (miratuar me nr. 276, datë 10.12.2019), Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka përgatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurës së vlerësimit për përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”.

Në pikën I të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) për gjyqtarët të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe për të cilët janë dorëzuar nga organet e rivlerësimit dosjet me aktet e vlerësimit profesional.

Në pikën II të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, proces i cili realizohet nëpërmjet shortit midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për relatorin, dhe ndërmjet nëpunësve të Njësisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional, sipas nenit 12, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 22.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”.

Në procedurën e shortit që do të zhvillohet për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar, Komisioni ka vlerësuar që të përfshihen të tre anëtarët e KVEVP, duke siguruar një shpërndarje të barabartë mes tyre. Ndërsa lidhur me numrin e nëpunësve përgjegjës

që do të angazhohen në vlerësimin etik dhe profesional sipas këtij projekt-akti, është administruar paraprakisht informacion për ngarkesën aktuale të të gjithë nëpunësve përgjegjës të Njësisë së Vlerësimit dhe mbi këtë bazë, është vlerësuar nga Komisioni përfshirja në këtë proces e nëpunësve që kanë ngarkesë më të ulët pune me raportet e procesit të rivlerësimit. Në këtë mënyrë garantohet jo vetëm barazia në shpërndarjen e punës por nuk cenohet as përparësia në përgatitjen e akteve ndihmëse për procesin e rivlerësimit kalimtar. Konkretisht në short propozohen që të përfshihen nëpunësit përgjegjës znj. Esmerilda Habili, znj. Gilda Hoxha dhe z. Fatbardh Çoniku.

Lidhur me procedurën e zhvillimit të shortit, Komisioni propozon të fillohet me përzgjedhjen e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, duke respektuar barazinë në shpërndarje, 6 për secilin. Bazuar në të njëjtin parim, më pas të vijohet me përzgjedhjen e relatorit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nëse anëtarët nuk do të kenë komente ose sugjerime lidhur me fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, për shkak të procedurave të ndjekura edhe në raste të tjera të shortit, do të sugjeroja që të vazhdonim me hedhjen e shortit.

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, kemi sugjerime lidhur me propozimin e bërë nga Komisioni për mënyrën se si do fillojë procedura e vlerësimit, mënyrën e hedhjes së shortit dhe emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësim. Nëse jo, atëherë të fillojmë me administratën për hedhjen e shortit. Shorti është manual. Në rastin konkret kemi tre enë. Në njëren enë do të futen shiritat e letrës me emrat e 18 gjyqtarëve.

Futen me radhë në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e 18 gjyqtarëve:

1. Znj. {...}; 2. Znj. {...}; 3. Z. {...}; 4. Z. {...}; 5. Z. {...}; 6. Znj. {...}; 7. Z. {...}; 8. Znj. {...}; 9. Z. {...}; 10. Znj. {...}; 11. Znj. {...}; 12. Znj. {...}; 13. Znj. {...}; 14. Znj. {...}; 15. Znj. {...}; 16. Znj. {...}; 17. Z. {...}; 18. Z. {...}.

Futen me radhë në enën tjetër të qelqit shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit:

1. Znj. Brikena Ukperaj; 2. Znj. Brunilda Kadi; 3. Z. Erjon Muharremaj.

Futen me radhë në enën e tretë të qelqit shiritat e letrës me emrat e nëpunësve përgjegjës për vlerësimin:

1. Znj. Esmerilda Habili; 2. Znj. Gilda Hoxha; 3. Z. Fatbardh Çoniku.

Pas hedhjes së shortit rezulton si më poshtë:

1. Për gjyqtaren {...}, relator z. Erjon Muharremaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

2. Për gjyqtaren {...}, relator znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

3. Për gjyqtarin {...}, relator znj. Brunilda Kadi dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

4. Për gjyqtaren {...}, relator z. Erjon Muharremaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

5. Për gjyqtaren {...}, relator znj. Brunilda Kadi dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

6. Për gjyqtaren {...}, relator znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

7. Për gjyqtaren {...}, relator znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

8. Për gjyqtaren {...}, relator z. Erjon Muharremaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

9. Për gjyqtarin {...}, relator znj. Brunilda Kadi dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

10. Për gjyqtaren {...}, relator z. Erjon Muharremaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

11. Për gjyqtaren {...}, relator znj. Brunilda Kadi dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

12. Për gjyqtarin {...}, relator znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

13. Për gjyqtarin {...}, relator znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

14. Për gjyqtarin {...}, relator z. Erjon Muharremaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

15. Për gjyqtarin {...}, relator znj. Brunilda Kadi dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

16. Për gjyqtarin {...}, relator znj. Brikena Ukperaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

17. Për gjyqtaren {...}, relator z. Erjon Muharremaj dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

18. Për gjyqtaren {...}, relator znj. Brunilda Kadi dhe nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

*Naureda Llagami:* Përpara se të kaloj projektaktin për votim, dëshiroj të lexoj të gjithë shortet për secilin nga gjyqtarët.

Projekt-akti i propozuar është:

I. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilët janë dorëzuar, nga organet e rivlerësimit, dosjet me aktet e vlerësimit profesional.

II. Caktimin e relatorit dhe nëpunësit përgjegjës për vlerësimin për secilin gjyqtar, si më poshtë:

1. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

2. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

3. Për gjyqtarin z. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

4. Për gjyqtarin z. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin Fatbardh Çoniku.

5. Për gjyqtarin z. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

6. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

7. Për gjyqtarin z. {...} - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

8. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

9. Për gjyqtarin z. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

10. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

11. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

12. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brikena Ukperaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

13. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

14. Për gjyqtaren znj. {...} - z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

15. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator z. Erjon Muharremaj - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Gilda Hoxha.

16. Për gjyqtaren znj. {...} - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

17. Për gjyqtarin z. {...} - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin znj. Esmerilda Habili.

18. Për gjyqtarin z. {...} - Relator znj. Brunilda Kadi - Nëpunës përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku.

Ky është propozimi. Kalojmë në votim të projekt-aktit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

*Ilir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projektvendimin sipas propozimit të Komisionit dhe shortit të hedhur këtu në prezencën tonë.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.06.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i relacionit mbi dhënien e komenteve dhe kundërshtimeve për raportin e Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2020-2021, profili gjyqtar”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i ngritur me vendimin nr.62, datë 30.01.2020.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 17:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i relacionit mbi dhënien e komenteve dhe kundërshtimeve për raportin e Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2020-2021, profili gjyqtar”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i ngritur me vendimin nr.62, datë 30.01.2020.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e relacionit mbi dhënien e komenteve dhe kundërshtimeve për raportin e Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2020-2021, profili gjyqtar”, i përgatitur nga Komisioni i Përkohshëm i ngritur me vendimin nr.62, datë 30.01.2020.

**Maksim Qoku:** Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 31, datë 23.01.2020, ka shpallur vendet vakante për kandidatët gjyqtarë për vitin akademik 2020 – 2021. Pas këtij vendimi nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës (në vazhdim SHM) në datë 29.01.2020, është vendosur që të bëhet publikimi i thirrjes për kandidime për pranimin në Formimin Fillestar. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka miratuar përbërjen e Komisionit të Administrimit të Provimit si dhe datën e zhvillimit të provimit të pranimit,



i cili sipas vendimit do të zhvillohet në datat 20 dhe 22 prill 2020. Në vendim është përcaktuar gjithashtu edhe periudha e regjistrimit për kandidatët në Formimin Fillestar, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 96/2016.

Në kushtet e gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga përhapja e COVID-19 dhe bazuar në efektet ligjore të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, i cili ndalonte organizimin e veprimtarive masive për një kohë të pacaktuar, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, vendosi anulimin e zhvillimit të provimit të pranimit dhe marrjen e masave për kryerjen e këtij aktiviteti, jo më vonë se 30 ditë nga mbarimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Në datë 22.05.2020 Këshilli i Shkollës së Magjistraturës vendosi afatin e ri për zhvillimin e provimit në datat 26 dhe 29 qershor 2020.

Me anë të njoftimit publik janë informuar të gjithë të interesuarit për fillimin e procedurës së aplikimeve, për periudhën gjatë të cilës Shkolla e Magjistraturës do të pranonte dhe mblidhte dokumentacionin e personave të interesuar, datat e zhvillimit të provimit të pranimit, kriteret që duhet të plotësoheshin sipas rastit, të parashikuara në nenin 28 të ligjit nr. 96/2016, si edhe në nenin 10 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, si dhe për dokumentet, që duhet të dorëzohen nga personat e interesuar, parashikuar në nenin 11 të Rregullores.

Për gjatë periudhës 1 deri në 29 shkurt 2020, sekretaria shkencore për Formimin Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës ka pranuar aplikimet nga personat e interesuar për të marrë pjesë në provimin e pranimit. Gjatë periudhës së regjistrimit, personat që kanë shprehur interesin dhe kryer procedurat e regjistrimit për të marrë pjesë në konkurs janë në total 277, nga të cilët:

- 89 aplikues për kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë;
- 43 aplikues për kandidatë për këshilltarë për ndihmës ligjorë dhe kandidatë për magjistratë;
- 233 aplikues vetëm për kandidatë për magjistratë (profili gjyqtar).

Pas përfundimit të periudhës së regjistrimit, Komisioni për verifikimin e dokumentacionit i ngritur në Shkollën e Magjistraturës, ka filluar punën për të verifikuar përmbushjen e kriterëve të konkurrentëve si edhe dokumentacionin e kërkuar nga ana e Shkollës për të dëshmuar plotësimin e këtyre kriterëve.

Më 11 mars 2020, mbi bazën e verifikimeve të kryera, Komisioni ka evidentuar gjetjet për çdo aplikim të paraqitur dhe ka arritur në përfundimin se:

- 277 kanë aplikuar për të konkurruar për magistrat, (prej të cilëve 1 ka konkurruar vetëm për prokuror dhe nuk është përfshirë në listën e totale, dorëzuar nga SHM);

- 261 prej aplikantëve të interesuar përmbushin kriteret ligjore për kandidatë për magistratë;

- 16 prej aplikantëve të interesuar nuk përmbushin kriteret ligjore për kandidat për magistrat (1 prej të cilëve ka konkurruar vetëm për prokuror dhe Shkolla e Magjistraturës e ka skualifikuar, por emri dhe dosja e kandidatit ndodhet i përfshirë në listën e të skualifikuarve të depozituar nga Shkolla e Magjistraturës. Dosja e kandidatit {...}, nuk merret në vlerësim nga KLGJ, pasi ka kandiduar vetëm për magistrat, profili prokuror).

Për sa me sipër nga KLGJ do të jepet opinion vetëm për 15 kandidatët e skualifikuar.

- 260 prej aplikantëve kanë përzgjedhur profilin për kandidat për gjyqtar.

Në vijim, konkluzionet e mësipërme i janë përcjellë Këshillit të Lartë Gjyqësor në respektim të pikës 4 të nenit 30 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit:

1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti.

2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kriterëve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit.

3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.

4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti.

Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.

5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe aktet nënligjore përkatëse.

Në zbatim të dispozitës së mësipërme, detyrë e Këshillit të Lartë Gjyqësor në rastin e kandidatëve që kanë aplikuar për gjyqtarë, është bërja e komenteve, sugjerimeve apo kundërshtime nëse ka të tilla, ndaj listës me vlerësimin paraprak të përmbushjes së kriterëve të kandidimit që ka bërë Shkolla e Magjistraturës. Të drejtën e miratimit të raportit të vlerësimit përfundimtar me listën e kandidatëve që kualifikohen për provimin e pranimit në formimin fillestar si dhe atyre që përjashtohen, e ka Shkolla e Magjistraturës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i detyruar që komentet apo sugjerimet e tij t’i ketë të bazuara në Ligj, në rastin konkret nenin 28 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit: 1. Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; c) ka përfunduar, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave”, si dhe ka dhënë provimin e shtetit për jurist në Shqipëri, ose ka kryer, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, studimet universitare për drejtësi në një vend anëtar të Bashkimit Evropian dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuara me ligj; ç) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare; d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë; dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; e) nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit; ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga

Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

Bazuar në kriteret e mësipërme ligjore, Shkolla e Magjistraturës ka detajuar në Rregulloren e Shkollës, neni 10 i saj, si më poshtë: 1. Shkolla e Magjistraturës, brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e përcaktimit dhe e publikimit të numrit maksimal të kandidatëve për magistratë, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për kandidatët për gjyqtarë dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për kandidatët për prokurorë, por jo më vonë se data 1 shkurt, shpall njoftimin për paraqitjen e kërkesave të aplikantëve për të konkurruar në provimin e pranimit, duke bërë të njohur datën e provimit, dokumentet që duhet të shoqërojnë kërkesat, datën e mbarimit të afatit për paraqitjen e tyre, si dhe programin e provimit të pranimit. 2. Shpallja e njoftimit bëhet: a) në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Shkollës së Magjistraturës; b) në të paktën një prej gazetave me tirazh më të lartë në vend. 3. Regjistrimi bëhet në përputhje me ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe me kushtet e përcaktuara në nenet 29, 30 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. 4. Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t’u pranuar në Formimin Fillestar për magistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) ka zotësi të plotë për të vepruar; b) është shtetas shqiptar; c) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave”, ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë, referuar nenit 124 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë”. Diplomimi i tyre duhet të mbështetet në përfundimin e një programi sipas sistemit të Bolonjës 5-vjeçar, ose të jetë diplomuar si “Jurist” me një diplomë universitare të fituar para përshtatjes së studimeve sipas sistemit të Bolonjës në një program 4-vjeçar, e cila është ekuivalente me një Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë, (DIND)”; d) ka notë mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë), si dhe notë mesatare mbi 8 (tetë) për grupin e lëndëve kryesore, ku përfshihen: E drejta civile dhe e detyrimeve, E drejta penale, (Pjesa e përgjithshme dhe pjesa e posaçme), Procedura civile, Procedura penale, E drejta administrative dhe e drejta kushtetuese. Për të diplomuarit “Juristë”, në programe në gjuhë të huaj, parashikohet një koeficient vështirësie i barabartë me 1.2, i cili do të ponderojë mesataren e tyre faktike; e) ka dhënë provimin e shtetit për jurist në Shqipëri,

ose ka kryer, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, studimet universitare për drejtësi në një vend anëtar të Bashkimit Evropian dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj; f) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, pas diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare; g) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë; h) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi; i) nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit; j) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; k) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete. 5. Nuk lejohen të konkurrojnë në Shkollën e Magjistraturës stafi i brendshëm i saj, si dhe familjarë apo persona të lidhur me ta, për një periudhë deri në një vit nga koha e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së tyre me Shkollën e Magjistraturës. 6. Kandidatët për pozicionet në Avokaturën e Shtetit i nënshtrohen të njëjtave rregulla për regjistrim dhe për konkurrim si kandidatët për magjistratë.

Bazuar në kriteret e mësipërme të vendosura nga Ligji dhe e detajuara nga Shkolla e Magjistraturës në rregulloren e saj, Këshilli konstaton se kualifikimi në raportin e vlerësimit paraprak, i 260 aplikantëve që kanë kandiduar në profilin gjyqtar, ka nevojë për komente dhe duhet të rivlerësohet nga Shkolla e Magjistraturës, para përpilimit të raportit të saj përfundimtar.

I. Në lidhje me listën e aplikantëve që janë kualifikuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor sugjeron që SHM duhet të rivlerësojë si më poshtë vijon:

1) Përbushjen e kriterit të përvojës profesionale nga aplikanti znj. {...}. Bazuar në dokumentet e depozituara nga aplikanti dhe nenin 28 germa ç, e ligjit nr.96/2016, Këshilli vlerëson se nuk përmbush kriterin e eksperiencës profesionale. Sipas librezës së punës, pozicioni që ka mbajtur aplikanti është “arkiviste”. Gjithashtu për këtë arsye, KLGJ me vendimin nr. 156, datë 15.05.2020, ka skualifikuar kandidatin {...}, nga lista e këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, pasi përvoja profesionale për këtë kandidat është

vetëm 11 muaj, duke mos i përfshirë pjesën tjetër të eksperiencës në punë për shkak të natyrës së ndryshme nga ajo që kërkon ligji.

2) Përmbushjen e kriterit të përvojës profesionale nga aplikanti z. {...}. Bazuar në dokumentet e depozituara nga aplikanti dhe nenin 28 germa ç, e ligjit nr.96/2016, Këshilli vlerëson se nuk përmbush kriterin e eksperiencës profesionale. Sipas librezës së punës, pozicioni që ka mbajtur aplikanti është “përgjegjës zyre në pikën e kontrollit doganorë Durrës”. Gjithashtu për këtë arsye KLGJ me vendimin nr. 156, datë 15.05.2020, ka skualifikuar kandidatin {...}, nga lista e ndihmësve ligjorë, pasi puna e kryer nga aplikanti nuk mund të merret në konsideratë si përvojë në profesion.

3) Përmbushjen e kriterit të përvojës profesionale nga aplikanti z. {...}. Bazuar në dokumentet e depozituara nga aplikanti dhe nenin 28 germa ç, e ligjit nr.96/2016, Këshilli vlerëson se nuk përmbush kriterin e eksperiencës profesionale. Sipas librezës së punës, pozicioni që ka mbajtur aplikanti është “përgjegjës turni në pikën doganore Kakavijë” dhe puna e kryer nga kandidati nuk mund të merret në konsideratë si përvojë në profesion.

4) Përmbushjen e kriterit të përvojës profesionale nga aplikanti znj. {...}. Bazuar në dokumentet e depozituara nga aplikanti dhe nenin 28 germa ç, e ligjit nr.96/2016, Këshilli vlerëson se nuk përmbush kriterin e eksperiencës profesionale. Aplikanti nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë (p.sh. librezë pune, vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për derdhje kontributi të kujtdo shteti, ose një dokument tjetër të barasvlershëm me to), eksperiencën profesionale.

5) Përmbushjen e kriterit të përvojës profesionale nga aplikanti znj. {...}. Bazuar në dokumentet e depozituara nga aplikanti dhe nenin 28 germa ç, e ligjit nr.96/2016, Këshilli vlerëson se nuk përmbush kriterin e eksperiencës profesionale. Sipas librezës së punës, pozicioni që ka mbajtur aplikanti është “Punonjëse shërbimi pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier” dhe puna e kryer nga kandidati nuk mund të merret në konsideratë si përvojë në profesion.

6) Përmbushjen e kriterit të përvojës profesionale nga aplikanti z. {...}. Bazuar në dokumentet e depozituara nga aplikanti dhe nenin 28 germa ç, e ligjit nr.96/2016, Këshilli vlerëson se nuk përmbush kriterin tre vjet eksperiencë profesionale. Në librezën e punës pozicioni që ka mbajtur aplikanti si jurist konfirmohet por Shkolla e Magjistraturës, ka

përfshirë në eksperiencën e punës dhe një periudhë prej 4 muaj, në të cilin vërtetohet se kandidati ka qenë në rolin e praktikantit pa pagesë, duke ia përfshirë kështu si eksperiencë profesionale. Këshilli vlerëson se kjo periudhë prej 4 muaj, nuk është e provuar si përvojë profesionale. Aplikanti, për këtë përvojë ka paraqitur vetëm një vërtetimi nga subjekti privat – punëdhënës. Ndërkohë, vërtetimi nuk jep asnjë të dhënë se ku ka qenë i regjistruar si i punësuar, pavarësisht faktit që nuk është paguar dhe gjithashtu nuk jep të dhëna se çfarë detyrash konkrete ka bërë aplikanti gjatë kësaj periudhë.

II. Në lidhje me listën e aplikantëve që sipas vlerësimit paraprak të Shkollës së Magjistraturës, nuk përmbushin kriteret ligjore, Këshilli ka konstatuar se disa nga gjetjet e SHM kanë nevojë për komente dhe duhet të rivlerësohen nga Shkolla e Magjistraturës para përpilimit të raportit të saj përfundimtar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor sugjeron që Shkolla e Magjistraturës duhet të rivlerësojë vendimin për skualifikim për kandidatët; {...}, {...}, {...}, të cilëve gjatë përlllogaritjes së viteve të eksperiencës profesionale nga Shkolla e Magjistraturës, nuk është marrë në konsideratë eksperiencia profesionale pas përfundimit të Bachelorit nga ana e aplikantëve.

Nga ana e Shkollës së Magjistraturës skualifikimi i tyre është bërë për shkak të mungesës së përvojës së nevojshme profesionale, pas përfundimit të plotë të studimeve universitare, duke përfshirë edhe “Masterin Shkencor”, sipas nenit 10, pika 4 shkronja “F” e Rregullores së Shkollës së Magjistraturës. Këshilli në lidhje me këtë arsyetim, ka parashtruar dhe në rekomandimet për aplikantët e vitit akademik 2019-2020, ku sugjeron që kjo përvojë profesionale të rivlerësohet referuar parashikimeve të nenit 28, pika 1 shkronja “ç” e ligjit nr.96/2016, i cili kërkon si kriter të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë. Nëse punësimi i të skualifikuarve ka qenë aktiv me kohë të plotë në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare, duke filluar që pas mbarimit të Bachelorit, sugjerojmë që kjo periudhë të njihet si përvojë pune profesionale edhe nëse aplikanti e ka kryer më pas Masterin Shkencor. Nuk mund të trajtohen në mënyrë të pabarabartë dhe të diferencuar, ata kandidatë që e kryejnë të njëjtën punë pas përfundimit të Masterit Shkencor, me ata që e kanë kryer atë që pas

mbarimit të Bachelorit, në kushtet kur ligji nuk e ndalon, dhe nuk shpreh kufizime për këtë lloj punësimi.

Ky është edhe opinioni i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve Ligjore.

**Brunilda Kadi:** Kryetare, dua të shtoj diçka tek relacioni, se është thjesht ndoshta një lapsus. Tek pika 6, në faqen 5 të relacionit, tek fjalia ku thuhet që “Këshilli vlerëson se kjo periudhë prej 4 muaj (bëhet fjalë për aplikantin {...})”, sugjeroj që të futet edhe pjesa si më poshtë: “Këshilli vlerëson se kjo periudhë prej 4 muaj, nuk është e provuar si përvojë profesionale, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 45/2016 për vullnetarizmin”. Thjesht sugjerojmë të shtohet tek fjalia.

**Naureda Llagami:** Okej!

Jeni dakord? Kemi pyetje ose sugjerime nga kolegët?

Nëse jo, i hedhim në votim komentet dhe sugjerimet, së bashku me propozimin e bërë nga zonja Kadi mbi shtesën e një togfjalëshi.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e komenteve dhe sugjerimeve ndaj raportit të Shkollës së Magjistraturës mbi rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2020-2021, profili gjyqtar, sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.



\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.06.2020)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”, përgatitur nga Komisionit i Përkohshëm ngritur me vendimin nr. 170 dhe nr. 171, datë 28.05.2020.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 17:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullore për funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”, përgatitur nga Komisionit i Përkohshëm ngritur me vendimin nr. 170 dhe nr. 171, datë 28.05.2020.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e radhës së rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e rregullore për funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”. Ky projekt-akt është përgatitur nga Komisionit i Përkohshëm ngritur me vendimin nr. 170 dhe nr. 171, datë 28.05.2020. Për më shumë detaje, ia jap fjalën kryetarit të këtij Komisioni, zotit Ilir Toska.

*Ilir Toska:* Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Përkohshëm, i ngritur sipas vendimit nr. 170, datë 28.05.2020, të KLGJ-së, në respektim të një nga urdhërimet e këtij vendimi sa i përket përgatitjes nga ana e Komisionit të Përkohshëm të një projekt-rregulloreje për

organizimin dhe funksionimin e këtij Komisioni, ka përgatitur një projekt-rregullore të tillë, e cila u është shpërndarë anëtarëve paraprakisht. Lidhur me projekt-rregulloren është përgatitur një relacion shpjegues, i cili edhe ky u është shpërndarë anëtarëve.

Sa i përket përmbajtjes së projekt-rregullores, përbëhet nga 31 nene.

Lidhur me përmbajtjen e tyre shpjegohet si më poshtë:

Konkretisht kreu I, neni 1 në këtë rregullore përcakton qëllimin e kësaj rregulloreje, që është përcaktimi i rregullave të detajuara për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm (KPSHA), paraqitjen dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, si dhe marrjen e vendimeve.

Neni 2 përcaktohet objekti i kësaj rregulloreje që është (i) përcaktimi i përgjegjësiave dhe kompetencave të KPSHA-së, (ii) përcaktimi i marrëdhënies së KPSHA-së me ankuesin, gjyqtarin, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, nëpunësin e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve dhe atij të personelit administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor; (iii) Përcaktimi i rregullave për paraqitjen, shqyrtimin dhe administrimin e dokumentacionit që lidhet me ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Në nenin 3 shprehen përkufizimet pra kuptimet në lidhje me: “Ankim”, “Gjyqtar”, “Këshill”, “Komision” ose “KPSHA”, “Ligji për Qeverisjen”, “Ligji për Statusin”, “Regjistër i posaçëm” “Vendim i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Në nenin 4 janë përcaktuar parime të përgjithshme të funksionimit. Sipas kësaj rregulloreje, parimet kryesore mbi bazën e të cilave zhvillon veprimtarinë Komisioni janë ato të: ligjshmërisë; transparencës; mbrojtjes së konfidencialitetit; mbrojtjes së të dhënave personale; drejtësisë dhe paanësisë; objektivitetit; barazisë dhe mosdiskriminimit dhe deburokratizimit dhe i efikasitetit. Shqyrtimi i çështjeve bëhet kolegjisht, mbi bazën e dokumenteve, si dhe në shqyrtimin e tyre përdoret gjuha shqipe.

Neni 5 përcakton fushën e veprimtarisë së Komisionit. Komisioni shqyrton të gjitha ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Në kreun e II-të i titulluar “Organizimi i Komisionit” ka këto rregullime:

Në nenin 6 me titull “Komisioni” rregullohet përbërja e Komisionit, çështjet që do të shqyrtojnë ky komision, mënyrën e marrjes së vendimeve si dhe vlefshmërinë e tyre. Kështu, Komisioni përbëhet nga tre anëtarë, dy jogjyqtarë dhe një gjyqtar, si dhe dy anëtarë zëvendësues; Shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bëhet kolegjisht nga tre anëtarë ndërsa i çështjeve të tjera, të ndryshme nga ato të përshkruara më lart, për sa nuk parashikohet ndryshe në këtë Rregullore, bëhet kolegjisht nga pesë anëtarë.

Në nenin 7 me titull “Kryetari i Komisionit” përcaktohet se Veprimtaria e Komisionit drejtohet dhe organizohet nga Kryetari i tij. Gjithashtu përcaktohet mënyra e caktimit të tij menjëherë pas zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit, ndërmjet anëtarëve jozëvendësues. Në këtë nen përcaktohen edhe kompetencat e kryetarit të komisionit.

Në nenin 8 me titull “Zëvendëskryetari i Komisionit” përcaktohet zgjedhja e Zëvendëskryetarit të Komisionit dhe kompetencat e tij. Komisioni propozon disa variante për mënyrën e zgjedhjes së zëvendëskryetarit për të cilat Këshilli në Mbledhje Plenare duhet të vendosë. Konkretisht propozohet zgjedhja e tij të bëhet sipas këtyre 5 varianteve:

Varianti i parë: Mbi propozimin e Kryetarit ose të çdo anëtari, zgjidhet Zëvendëskryetari i tij.

Varianti i dytë: Pas shprehjes së interesit nga anëtarët, zgjidhet Zëvendëskryetari i tij.

Varianti i tretë: Anëtarët zgjedhin si Zëvendëskryetar të Komisionit anëtarin e tij më të vjetër në detyrë dhe, kur kjo nuk është e mundur, anëtarin që ka përvojën profesionale si jurist më kohëzgjatjen më të madhe.

Varianti i katërt: Në mbledhjen e parë të Komisionit, zgjidhet Zëvendëskryetari i Komisionit. Si Zëvendëskryetar i Komisionit zgjidhet anëtari zëvendësues që vjen nga e njëjta radhë nga vjen Kryetari.

Varianti i pestë: Në mbledhjen e parë të Komisionit, zgjidhet Zëvendëskryetar i Komisionit. Si Zëvendëskryetar zgjidhet anëtari zëvendësues që vjen nga e njëjta radhë nga vjen Kryetari në rastin kur ai vjen nga radhët e gjyqtarëve ose anëtari tjetër i Komisionit kur Kryetari vjen nga radhët e jogjyqtarëve.

Gjithsesi, Komisioni është për variantin e parë të propozuar “Varianti i parë: Mbi propozimin e Kryetarit ose të çdo anëtari, zgjidhet Zëvendëskryetari i tij.”

Neni 9 në rregullore parashikon zëvendësimin e përkohshëm të anëtarit të Komisionit. Ndërkohë në nenin 10 të rregullores me titull “Njësia Mbështetëse e Komisioneve” përcakton se anëtari i Komisionit, asistohet nga nëpunësi i Njesisë Mbështetëse të Komisioneve, i cili ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Komisionit duke përfshirë, si dhe çdo detyrë tjetër që i caktohet nga Kryetari ose Komisioni si dhe “Kryetari i Këshillit cakton një nëpunës të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve për secilin nga anëtarët e Komisionit”. Në këtë nen gjithashtu rregullohet edhe rasti i konfliktit të interesit ose të një pengese ligjore nga ana nëpunësit të Njesisë Mbështetëse të Komisioneve.

Në nenin 11 është rregulluar asistimi i Komisionit nga një nëpunës i personelit administrativ të Këshillit, i cili ushtron veprimtari ndihmëse, duke përfshirë: mbajtjen e regjistrit të posaçëm, përgatitjen dhe hedhjen e shortit dhe dokumentimin e mbledhjeve të Komisionit, si dhe çdo detyrë tjetër që i caktohet nga Kryetari. Ky nëpunës për të asistuar veprimtarinë e Komisionit caktohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Edhe në këtë rast është rregulluar rasti i konfliktit të interesit ose të një pengese ligjore nga ana e nëpunësit të personelit administrativ të Këshillit.

Në nenin 12 të kësaj rregulloreje me titull “Paraqitja e ankimit” përcaktohet personi që paraqet në Këshill ankimin lidhur me vendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimi i hetimit ndaj një gjyqtari, mënyra e paraqitjes së ankimit, përmbajtja e tij, dokumentacioni shoqërues. Ankimi regjistrohet në regjistrin e posaçëm që mbahet pranë Komisionit.

Në nenin 13 “Ndarja me short e ankimit”, rregullohet organizimi i shortit për caktimin e relatorit, pas regjistrimit të ankimit. Shorti organizohet të paktën një herë në dy javë në prani të anëtarëve të Komisionit, e cila nuk është e detyrueshme. Në mënyrë të detajuar në këtë nen përshkruhet mënyra e organizimit të shortit, ndarja e ankimeve sipas dy kategorive, ndarja e tyre në mënyrë të rastësishme dhe të barabartë midis anëtarëve, raporti kryetar/anëtar lidhur me ankimet. Për shortin e organizuar mbahet procesverbal, ku pasqyrohen data, ankimet që do të hidhen në short identifikuar sipas numrit rendor të regjistrit dhe identitetit të ankuesit, pjesëmarrësit në short, vendimet paraprake të Komisionit, si dhe rezultatet e shortit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë

pjesëmarrësit, sikundër ky procesverbal të protokollohet dhe arkivohet në Zyrën e Protokoll-Arkivës së Këshillit.

Neni 14 përcakton veprimet e relatorit për verifikimin nëse ankimi plotëson kriteret formale të parashikuara në këtë Rregullore, si dhe në rastet kur nuk i plotëson kriteret, ndërsa në nenin 15 parashikon “Shqyrtimin paraprak të ankimit” ku pas verifikimit të kriterëve formale të ankimit, relatori verifikon kushtet e pranueshmërisë së tij për shqyrtim. Gjithashtu në rregullore janë parashikuar edhe rastet kur vendoset pushimi i shqyrtimit të ankimit (neni 16).

Në kreun e III-të është parashikuar funksionimi i Komisionit duke rregulluar në dispozitat që i përkasin këtij kreu:

- mënyrën e shqyrtimit të ankimit në mbledhjen e Komisionit me pjesëmarrjen e relatorit;

- kufijtë e shqyrtimit të ankimit që duhet të jenë brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në të;

- thirrja e mbledhjes nga Kryetari i Komisionit, si dhe mënyra e zhvillimit të saj;

- të drejtat e anëtarit të Komisionit, dhe detyrat e relatorit të çështjes;

- heqjen dorë nga shqyrtimi i ankimit anëtarit të Komisionit si dhe rregullohet përjashtimi i anëtarit;

- veprimet që kryhen për shqyrtimin e ankimit gjatë zhvillimit të mbledhjes;

- vendimmarrje e Komisionit dhe konkretisht përcaktohet se Komisioni vendos:

- a) Refuzimin e ankimit si të pabazuar, nëse ai nuk përmbush kushtet e pranueshmërisë apo nuk është i mbështetur;

- b) Shfuqizimin e vendimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe, sipas rastit, urdhërimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për verifikimin e ankesës së arkivuar ose vazhdimin e hetimit ndaj një gjyqtari.

Vendimi i Komisionit arsyetohet nga relatori dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në shqyrtim. Ky vendim i njoftohet subjektit.

Në nenin 27 parashikohet që Vendimet e Komisionit janë përfundimtare dhe nuk mund të apeloohen para mbledhjes plenare të Këshillit.

Neni 28 “Njoftimi dhe publikimi i vendimit të Komisionit” rregullon mënyrën e njoftimit të vendimit të Komisionit. Vendimi i njoftohet ankuesit, gjyqtarit dhe

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në një ose disa nga format e përcaktuara në këtë nen si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Sipas përcaktimeve në nenin 29 “Praktika dokumentare e ankimit, me urdhër të relatorit, arkivohet në Zyrën e Protokoll-Arkivit të Këshillit në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi arkivat”

Neni 30 rregullon kohëzgjatjen e veprimtarisë së Komisionit e cila përcaktohet me vendim të Këshillit.

Dhe së fundmi në nenin 31 përcaktohet që “Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe botimin e saj në faqen zyrtare të internetit të Këshillit”. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Atëherë, përpara se të kalojmë në tërësi të gjithë rregulloren, duke qenë se nga ana e Komisionit kanë ardhur propozime lidhur me nenin 8, në fillim do të doja që të kalonim në votim propozimet e formulimit të parë për nenin 8, në bazë të të cilit thuhet që “Neni 8 - Në mbledhjen e parë të Komisionit, mbi propozimin e Kryetarit ose të çdo anëtari, zgjidhet Zëvendëskryetari i tij.” Ky është propozimi i parë. E kalojmë në votim këtë propozim.

***Maksim Qoku:*** Dakord.

***Brunilda Kadi:*** Dakord.

***Ilir Toska:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Marçela Shehu:*** Dakord.

***Erjon Muharremaj:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Medi Bici:*** Pro.

***Naureda Llagami:*** Dakord.



Atëherë, kalojmë të gjithë Rregulloren sipas propozimit të bërë nga Komisioni në tërësi.

*Maksim Qoku*: Dakord.

*Brunilda Kadi*: Dakord.

*Illir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.06.2020)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.83, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr.86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (vijon nga mbledhja e datës 04.06.2020).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 17:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>  | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>      | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Ilir Toska</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.83, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr.86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (vijon nga mbledhja e datës 04.06.2020).

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në çështjen e radhës të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr.83, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr.86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do të raportohet nga zoti Ilir Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Kjo pikë e rendit të ditës është e shtyrë nga mbledhja e mëparshme. Këshilli konsideroi që të përsërisë ftesën për dy nga kandidatët, z. {...} dhe znj. {...}, në lidhje me përcaktimin e pozicionit për të cilin kanë kandiduar, konkretisht për zotën {...} për pozicionin e tretë, ndërsa për zonjën {...} për pozicionin e dytë dhe të tretë për të cilin

kandidon, në kushtet kur zoti {...} ka kandiduar për 6 pozicione të lira, ndërsa zonja {...} për 5 pozicione të lira. Ndërkohë që pika 6 e nenit 48 e ligjit për Statusin përcakton mundësi kandidimi për jo më shumë se 3 pozicione të lira.

Komisioni i dërgoi ftesat i dy kandidatëve dhe janë kthyer përgjigjet nga ana e tyre. Zoti {...} konsideron të njëjtën përgjigje që i ka kthyer edhe Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, pra që ai ka kandiduar vetëm për 1 pozicion, pavarësisht se ka paraqitur 6 kërkesa. Po kështu edhe zonja {...} referon që ka konkurruar për 1 pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë nëpërmjet 5 kërkesave.

Ndërkohë, lidhur me zonjën {...}, edhe në përgjigjen dhe ftesën që i ka bërë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës paraprakisht por edhe në ftesën që i bëri Këshilli, në pjesën e fundit të përgjigjes së saj ka referuar se: “Ndërsa në përgjigje të ftesës suaj për të përcaktuar preferencën e kandidimit, rendis të parat vendet e lira në fushën e së drejtës civile të shpallura me vendimet nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020 të KLGJ-së.”

Marrë shkas nga ky qëndrim i kandidatës znj. {...}, ndërsa për katër pozicionet e mbetura për shqyrtim, ato të shpallura me vendimet nr. 83, nr. 84, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, ajo shprehet për preferencë kandidimi për dy nga këto pozicione, pikërisht ato të shpallura me vendimet nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, një qëndrim i tillë, ndërsa nuk ka të bëjë me renditjen e pozicioneve sipas preferencave, mund të interpretohet si përcaktim i pozicionit të dytë dhe të tretë për të cilat kandidatja znj. {...} kandidon.

Nisur nga kjo, ditën e sotme ne ju kemi përcjellë edhe një projektvendim sa i përket vetëm pikës 5 të projektvendimit, që të ketë një variant tjetër, duke marrë në konsideratë pikërisht këtë përgjigje të zonjës {...} dhe sipas propozimit të sotëm, pika 5 të ketë këtë përmbajtje: “5. Mospërfshirjen e aplikueses znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.”

Sa i përket pikave të tjera të projektvendimit, Komisioni Konsideron ato që janë bërë në projektvendimin fillestar, kështu që mund të vazhdojmë shqyrtimin sipas propozimit që ne kemi paraqitur.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Përpara se të kalojmë në miratimin në tërësi të projekt-aktit të propozuar nga Komisioni juaj, të hidhet procedura e shortit për kandidatin zotin {...}.

Siç kemi proceduar gjithmonë, nga administrata janë vënë në dispozicion tre emrat e relatorëve të cilët do futen në vazon e qelqit.

Emri i parë i relatorit – Alban Toro.

Emri i dytë i relatorit – Ilir Toska.

Emri i tretë i relatorit – Marçela Shehu.

Hidhet shorti për relatorin – zn. Marçela Shehu.

Hidhet në votim pika 5, sipas propozimit të bërë pak më lart nga relatori, propozim i cili lexohet edhe një herë nga relatori: “5. Mospërfshirjen e aplikueses znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.”

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve që kanë aplikuar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimin nr.83, datë

26.02.2020 (në fushën e së drejtës administrative) dhe me Vendimin nr.86, datë 26.02.2020 (në fushën e së drejtës civile), të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

Për kandidatin z. {...} - relator znj. Marçela Shehu.

3. Për kandidatët znj. {...} – {...}, të cilët kanë aplikuar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë edhe për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82 dhe nr. 85, datë 26.02.2020, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimin e tyre, sipas rastit, për një ose të dyja pozicionet e lira të shpallura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimet nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020.

4. Mospërfshirjen e aplikuesit z. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 84, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.

5. Mospërfshirjen e aplikueses znj. {...} në listën e kandidatëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 83 dhe nr. 84, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të ndalimit nga ligji të kandidimit për ngritjen në detyrë për më shumë se tre pozicione të lira të shpallura në të njëjtën kohë.

6. Disponimi sipas pikave 4 dhe 5, të këtij vendimi, u njoftohen aplikuesve z. {...} dhe znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

7. Aplikuesit z. {...} dhe znj. {...} kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit respektivisht të pikave 4 dhe 5, të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në votimin në tërësi të projekt-aktit.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

*Ilir Toska*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Medi Bici*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.06.2020)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 17:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)



**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen e radhës së rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Alban Toro.

**Alban Toro:** Atëherë, Komisioni ka përgatitur një relacion “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër” dhe jua kemi dërguar nëpërmjet e-mailit edhe aktet të cilat kanë shoqëruar formatimin e këtij relacioni. Kështu që në mënyrë të sentitizuar po jua paraqes me pak fjalë përmbajtjen e tij.

Më herët KLGJ me Vendimin nr. 193, datë 04.06.2020 ka shpallur një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për transferim të përkohshëm deri në një vit. Kjo shpallje i është drejtuar gjyqtarit të transferuar, aktualisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër z. {...}, i cili është ftuar për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

Kështu, Komisioni, në përputhje me vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i është drejtuar gjyqtarit në fjalë për t’i marrë pëlqimin dhe njëkohësisht ka kërkuar edhe opinionin e zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë në lidhje me ngarkesën e gjykatës të cilën drejton në përgjithësi; pasojat që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër; si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari kërkohet të transferohet duke marrë në konsiderate efektet negative të shkaktuara nga ky transferim.

Pasi ka administruar të dhënat e ardhura nga gjykata si dhe pëlqimin e gjyqtarit, duke vlerësuar ngarkesat aktuale të dy gjykatave, për të siguruar funksionimin normal të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, e cila ka pozicione të lira të përkohshme, si dhe duke marrë në konsideratë edhe organikat përkatëse të të dy gjykatave, Komisioni ka propozuar nëpërmjet një draft vendimi, në dispozitivin e të cilit ju do të gjeni: 1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për një periudhë deri në 1 vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. 2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 16.06.2020. 3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në eventualitetin që Këshilli do ta pranojë këtë propozim, duke sanksionuar me një vendim të veçantë, do na duhet të rregullojmë edhe një parregullsi të cilën e kam konstatuar gjatë përgatitjes së materialit dhe e cila konsiston me vazhdimin e ushtrimit të funksionit të zëvendëskryetarit nga zoti {...}, i cili është një gjyqtar, që siç rezulton nga ky relacion, është i transferuar në mënyrë të përkohshme, pra nuk është një gjyqtar i caktuar në mënyrë të përhershme në atë gjykatë. Pra këtë lloj funksioni do duhet normalisht ta kryente një gjyqtar i kësaj gjykate i caktuar në mënyrë të përhershme, konform vendimit nr. 7, 21.12.2018, e cila rregullon zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave.

Zoti {...} e ka ushtruar këtë funksion për efekt sepse kjo gjykatë nuk ka pasur gjyqtarë, por me emërimin e gjyqtarëve të rinj në këtë gjykatë administrative, besoj që edhe detyra e tij për ta ushtruar këtë duhet të ishte ezauruar, prandaj, së bashku me njoftimin (gjithmonë në eventualitetin që do të pranohet ky propozim i Komisionit) e këtij gjyqtari, duhet t'i çohet edhe një shkresë trupës gjyqësore të kësaj gjykate ku të njoftohet për këtë fakt dhe të bëjnë zgjedhjen përkatëse të zëvendëskryetarit, konform rregullores apo vendimit nr. 7, 21.12.2018. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar përpara se të kalojmë në procedurën e votimit?

Po, zonja Ukperaj!

**Brikena Ukperaj:** Vendimi titullohet “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...}”. Me sa konstatoj, në pjesën e dispozitivit të vendimit flitet thjesht për përsëritjen e transferimit të përkohshëm, ndërkohë që në relacion referohet edhe për mbarimit të funksionit të zëvendëskryetarit. Domethënë, ideja është që ky gjyqtar do vazhdojë të jetë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe nuk duhet të ushtrojë funksionin e zëvendëskryetarit? Sepse këto janë dy çështje të ndryshme.

Do miratojmë transferimin apo do miratojmë mbarimin e funksionit të zëvendëskryetarit?

**Alban Toro:** Sot do miratojmë transferimin. Por do duhet që për administrimin normal të kësaj gjykate, këtë detyrë ta ushtrojë një zëvendëskryetar i zgjedhur nga trupa gjyqësore e gjyqtarëve të caktuar në mënyrë të përhershme në këtë gjykatë. Kështu që kam menduar që të njëjtin problem ta zgjidhim me një shkresë, ku të njoftohet trupa gjyqësore për të ushtruar kompetencën e vet. Kaq.

Pra sot ka lidhje vetëm me përsëritjen e transferimit. Kjo është vendimmarrja.

Me shkresën që ne duhet të njoftojmë gjykatat përkatëse, normalisht do njoftohet edhe kryetari i gjykatës, i cili korrespondon që të jetë po {...}, por që nuk është zgjedhur, pra me prurjet e reja që ka kjo gjykatë, duhet të ishte zgjedhur një person i caktuar në mënyrë të përhershme në këtë gjykatë. Pra doja të rregulloja këtë fakt. Faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Unë mendoj që sot të marrim një vendim lidhur me çështjen e transferimit, pastaj çështja nëse i mbarojnë funksionet e zëvendëskryetarit apo jo, mendoj që duhet të kalojë prapë në vendimmarrje sepse funksioni i zëvendëskryetarit ia kemi dhënë me rregullore për shkak të një dispozite që kemi shtuar tek rregullorja për procedimin e zgjedhjes së zëvendëskryetarëve ose kush do të konsiderohet zëvendëskryetar në një gjykatë kur asnjë nga gjyqtarët nuk plotëson kushtet.

Unë sot do të votoj për sa i përket pjesës së përsëritjes së transferimit dhe nuk mund të votoj për pjesën e mbarimit të funksionit si zëvendëskryetar. Mendoj që nuk është thjesht një shkresë që duhet të dërgohet, por duhet një vendim nga ana e Këshillit për këtë pjesë.

**Marçela Shehu:** Në momentin e miratimeve të ndryshimeve në rregulloren për zgjedhjen e zëvendëskryetarit, ne nuk kemi disponuar me një vendim lidhur me këtë fakt, pra për caktimin në këtë pozicion të zotit {...}. Me sa më kujtohet, ne i kemi dërguar një shkresë gjykatës, ku i kemi bërë me dije që të vijojnë dhe të procedojnë bazuar në përcaktimet e rregullores dhe konkretisht të vendimit nr. 7, datë 21.12.2018, me atë ndryshimin përkatës në nenin 7, pika 2. Kështu që në rastin kur ne nuk kemi disponuar me vendim por vetëm i kemi bërë me dije mundësinë e aplikimit të kësaj dispozite, atëherë edhe në këtë rast aplikohet në të njëjtën mënyrë, duke qenë se zëvendëskryetari do zgjidhet nga vetë gjykata dhe jo nga Këshilli. Kështu që, në vlerësimin tim nuk ka nevojë për një vendim formal. Mund t'i dërgojmë një shkresë në të njëjtën formë si herën e parë dhe duke i bërë me dije situatën faktike që është sot.

Në kushtet kur zoti {...} mori përsipër të ushtronte detyrën e zëvendëskryetarit, bazuar në vendimin që sipër citova, ishte i vetmi gjyqtar i asaj gjykate, megjithëse ishte i transferuar, por vendimi nr. 7, pra kjo rregullore, i jepte mundësi që të ushtronte funksionin e zëvendëskryetarit.

Tani situata ka ndryshuar. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër janë tre gjyqtarë të përhershëm të caktuar, që ushtrojnë detyrën. Kështu që, bazuar në të njëjtat rregullime, bazuar në të cilën u përzgjedh zoti {...} për të ushtruar funksionin e zëvendëskryetarit, bazuar në të njëjtat rregullime, çmoj se Këshilli i Gjykatës, trupa gjyqësore ka kompetencë që të përzgjedhë tashmë zëvendëskryetarin e ri, bazuar në përcaktimet që jep vendimi nr. 7, datë 21.12.2018. Faleminderit!

**Brunilda Kadi:** Mundem Kryetare?

**Naureda Llagami:** Po, Bruna!

**Brunilda Kadi:** Atëherë, unë mendoj që ndoshta ne duhet të ishim shprehur edhe më përpara, sepse mendoj që, që në momentin që një gjyqtar është emëruar/caktuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër si gjyqtar i përhershëm, zoti {...} nuk duhet të kishte ushtruar detyrën e zëvendëskryetarit, për të gjitha ato arsye që u thanë edhe nga zonja Shehu. Kështu që edhe unë mendoj që nuk ka nevojë për një vendim. Jam dakord me Brikenën që të hidhet në votë tani miratimi i përsëritjes së transferimit, ndërsa në lidhje me zëvendëskryetarit, nëse gjykata nuk ka vepruar dhe ne nuk kemi reaguuar, duhet ndoshta t’iu dërgojmë një komunikim nga Këshilli që ata menjëherë duhet të zgjedhin zëvendëskryetarin sipas ligjit dhe rregullores. Për mendimin tim, zoti {...} nuk mund të ushtrojë më asnjë moment atë lloj detyre.

**Naureda Llagami:** Ndonjë diskutim tjetër?

Po, zoti Toska!

**Ilir Toska:** Atëherë, në rendin e ditës kemi vendimin “Për përsëritjen e transferimit të z. {...}”. Mendoj që të diskutojmë paraprakisht për këtë gjë sepse i gjithë diskutimi që po bëhet më përpara do duhet të konsiderohet mbasi kemi votuar për projektvendimin që kemi në rend dite, sepse mund të ndodhë që mos të miratohet ai projektvendim dhe nuk është më situata që kolegët po diskutojnë për periudhën mbas. Kështu që, përfundojmë projektvendimin që kemi në rend dite dhe pastaj duhet të konsiderojmë shqetësimin që ngriti zoti Toro, zonja Shehu dhe zonja Kadi sa i përket drejtimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, ndonjë diskutim tjetër?

Atëherë, vijojmë me hedhjen në votim të projektvendimit, i cili ka të bëjë me përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...}, në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, për një periudhë deri në 1 (një) vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. 2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 16.06.2020. 3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës e cila ka të bëjë me përsëritjen e transferimit të gjyqtarës {...}.

**Brunilda Kadi:** Kryetare, një sekondë, se ne nuk e zgjidhëm situatën që thamë do ta diskutonim pas votimit, në lidhje me zëvendëskryetarin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

A thamë që do ta diskutonim, siç sugjeroi zoti Toska, mbasi të miratonim këtë, të vendosim çfarë do bëjmë?

Unë jam pro propozimit të zotit Toro që t'i dërgojmë asaj gjykatë një njoftim që, menjëherë të vijojë procedurat sipas ligjit dhe rregullores që kemi miratuar për të zgjedhur zëvendëskryetarin sipas ligjit.

**Naureda Llagami:** Pra hedhim në votim propozimin e bërë nga zoti Toro, zonja Kadi dhe nga zonja Shehu lidhur me dërgimin e një shkrese nga ana e Këshillit.

**Brikena Ukperaj:** Pasi u konsultova pak me rregulloren për zgjedhjen e zëvendëskryetarit, në situatë faktike, në dijeninë time, asnjë prej gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër nuk plotësojnë kushtet për të qenë

zëvendëskryetarë sepse nuk kanë përvojën e duhur; dhe në vendimin nr. 137, datë 19.07.2019, në të cilin kemi bërë një shtesë në rregulloren për miratimin e zgjedhjes së zëvendëskryetarëve, ne kemi thënë: “Kur asnjë prej gjyqtarëve në detyrë nuk plotëson kriteret për t’u zgjedhur zëvendëskryetar apo zgjedhja e tij nga mbledhja e gjyqtarëve të gjykatës është objektivist e pamundur, konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë”.

Kështu që, në këtë rast, nëse do të përjashtojmë zotin {...} nga zgjedhja si zëvendëskryetar, nuk ka nevojë prapë për një votim sepse asnjë prej gjyqtarëve të gjykatës nuk plotësojnë kushtet për të qenë zëvendëskryetar. Kështu që, në vlerësimin tim, mbledhja e gjyqtarëve nuk mund të bëhet, por thjesht, përsëri Këshilli duhet të rikonsiderojë se cili nga ata gjyqtarë do të konsiderohet zëvendëskryetar, duke referuar edhe datën e dekretimit të tyre. Nuk e di nëse ndonjëri prej tyre ka më shumë se 1 vit. Dekretimi i fundit, i gjyqtarit të parë, është në 2019 dhe pastaj gjyqtarët e tjerë janë dekretuar në vitin 2020.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Ukperaj!

**Marçela Shehu:** Brikena më fal, po propozon që me anë të një shkrese ne t’i referohemi për emrin konkret të gjyqtarit që plotëson ato kritere që thotë pika 2 e nenit 7 për të ushtruar funksionin e zëvendëskryetarit?

Pra t’i dërgojmë një shkresë dhe të referojmë emrin konkret?

Apo t’i kërkojmë gjykatës që të marrë në konsideratë 2 fakte, faktin e parë që tashmë janë tre gjyqtarë të përhershëm, pra kanë mundësi të zgjedhin njërin midis tyre dhe faktin e dytë, që të zbatojnë pikën 2 të nenit 7.

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, në vlerësimin tim, asnjë prej gjyqtarëve të cilët janë të emëruar në mënyrë të përhershme, nuk plotësojnë kushtet për t’u zgjedhur zëvendëskryetar. Parashikimi i rregullores është i qartë. Nëse asnjë prej tyre nuk i plotëson këto kushte, konsiderohet i zgjedhur zëvendëskryetar ai që ka përvojën profesionale më të gjatë. Kështu që, mjafton që ky vendim t’iu dërgohet për zbatim, për të rikonsideruar gjyqtarin që do të kryejë funksionin e zëvendëskryetarit, që do jetë normalisht gjyqtari që është dekretuar më herët. Në vlerësimin tim nuk ka nevojë për mbledhje. Mjafton një njoftim.

**Brunilda Kadi:** Po dakord pra.

Ideja është që për mua zoti {...} nuk është më përfaqësues i asaj gjykate. Në datën 16 qershor, kur i mbaronte transferimi... siç e thashë edhe më përpara, për mua ai nuk duhet të kishte ushtronte detyrën qëkur vajti gjyqtar i parë i përhershëm aty. Megjithatë, minimumi në datën 16 qershor 2020 kur atij i mbaronte transferim sipas vendimmarrjes së mëparshme, ajo gjykatë mbetet pa përfaqësues ligjor dhe ne thjesht mund t'i dërgojmë një kujtesë gjykatës që të ndërmarrë veprimet sipas ligjit dhe të zgjidhet ai personi siç thotë ligji dhe ajo që cituat juve, akti nënligjor. Mendoj që kjo duhet të bëhet urgjent sepse sot është data 11 dhe për mua, në datën 16 ajo gjykatë është pa përfaqësues ligjor.

Hedhim në votim atëherë këtë që duket sikur u formulua nga Brikena, apo jo Brikena? Të themi që caktimi i zëvendëskryetarit do bëhet sipas formulimit.

**Brikena Ukperaj:** Hedhim në votim faktin që funksionet e zëvendëskryetarit në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Shkodër do të kryhen në vijim nga gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë.

**Brunilda Kadi:** Gjyqtari i përhershëm.

**Marçela Shehu:** Po pra, gjyqtari i përhershëm. Se nuk duhet të konfondohej më me...

**Brikena Ukperaj:** Po, patjetër! Gjyqtari i emëruar në mënyrë të përhershme, në zbatim të rregullores që kemi.

**Alban Toro:** Brikena më fal! Duhet t'i interpretojmë në rregulloren gjyqtarëve atje? Normalisht që ato janë të vetëdijshëm se kush ka ardhur i pari dhe kush ka ardhur i fundit. Kështu që, rregulloren e kanë dhe le ta gjejnë midis tyre.

**Brikena Ukperaj:** Sepse dikush nga ne mund të mendoj sot Alban që funksionet e zëvendëskryetarit nuk i kanë mbaruar zotit {...}.

**Alban Toro:** Por fakti që ne po i drejtohem me shkresë dhe i tërheqim vëmendjen që trupa gjyqësore duhet të orientohet të zbatojë vendimin nr. 7 dhe të zgjedhë zëvendëskryetarin konform këtij vendimi, kjo nënkupton qartë që atij i ka mbaruar. Por këtë nuk mund ta ushtrojë, pra institucioni ynë të zgjedhë zëvendëskryetarin dhe t'i thotë që filan dekret ka mbaruar. Ata dekretet i disponojnë sepse përpos tyre janë emëruar, rregulloren e kanë dhe duhet ta zbatojnë dhe le ta interpretojnë.

**Brunilda Kadi:** Si ta bëjnë? Në mbledhje ta zgjedhin?



**Alban Toro:** Patjetër! Bile edhe një përfaqësuesi ynë atje duhet të shkojë dhe t'i ndihmojë ndoshta, siç kemi bërë në vazhdimësi me zëvendëskryetarët e tjerë, që ka marrë pjesë një përfaqësues i KLGJ-së.

**Ilir Toska:** Me leje?

Atëherë, zgjedhja e zëvendëskryetarit nuk është kompetencë e KLGJ-së dhe ne nuk kemi çfarë lloj vendimi të marrim. Nëse duhet të bëjmë ndonjë njoftim për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, e bëjmë atë njoftim, por nuk është çështje që do duhet të marrim ne ndonjë vendim në mbledhje plenare. Shqetësimi u përcoll. Duhet të konsiderojmë se si ta zgjidhim nëpërmjet njoftimit. Nuk kemi çfarë vendimi të marrim për këtë rast.

**Marçela Shehu:** Dakord. Ideja ishte të binim dakord që ky është vullneti i të gjithëve që të procedojmë në këtë formë.

**Ilir Toska:** Dakord biem të gjithë ne, se për të gjitha biem dakord. Por nuk është se duhet të marrim ndonjë vendim që biem dakord. Kështu që jashtë mbledhjes bëjmë atë njoftimin dhe e nisim. Nuk kemi çfarë vendimi të marrim tani.

**Brunilda Kadi:** Atëherë, duhet të mblidhen?

**Ilir Toska:** Nuk kemi çfarë vendimi të marrim, të mblidhen apo të mos mblidhen. Kush zgjidhet dhe kush nuk zgjidhet. Nuk i bëjmë ne këto. Ne duhet t'i njoftojmë.

**Marçela Shehu:** Jo pra, ne kemi detyrimin për t'i njoftuar, që kjo është situata që duhet të konsideroni.

**Ilir Toska:** U mor vesh shqetësimi. Jemi të gjithë të ndërgjegjshëm që duhet të respektohet ligji dhe do ta bëjmë këtë njoftimin. Unë nuk e di se çfarë vendimi duhet të marrë tani.

**Brunilda Kadi:** Jo pra, ndoshta Këshilli me një akt formal i thotë asaj gjykate, bazuar në ato dispozita që konsideron si të zgjedhur si zëvendëskryetar magjistratin “x” “y” për këto arsye.

**Ilir Toska:** Do marrim ndonjë vendim sot për të gjithë këtë formulimin që bëre Bruna?

**Brunilda Kadi:** Po përderisa kjo lloj zgjidhjeje që kemi gjetur ne tek rregullorja për shkak të situatave që nuk janë parashikuar ekzakt në ligj është një lloj sanksionimi, ata vetë trupa gjyqësore çfarë veprimi formal mund të ndërmarrin, do mblidhen dhe do

thonë do zbatojmë rregulloren? Si do ta zgjidhin? Meqë ne jemi përgjegjës për administrimin e gjyqësorit.

**Ilir Toska:** Atëherë, kush është propozimi për vendimmarrje zonja Kadi? Se unë nuk e kuptoj.

Ajo që unë po them është se nuk kemi se çfarë vendimi të marrim në mbledhje plenare. Ndërkohë shqetësimi qëndron dhe ne duhet ta konsiderojmë ta njoftojmë atë gjykatë që ta zgjedhë zëvendëskryetarin sipas rregullave ligjore.

**Brunilda Kadi:** Këtë po them edhe unë, ta njoftojmë. Këtë gjë po them edhe unë, por ta bëjë Këshilli.

**Ilir Toska:** Tani, nuk e kuptoj. Do marrë vendim për njoftim?

**Brunilda Kadi:** Jo të marrim vendim. Hajde të biem dakord që, jemi të gjithë okej me këtë lloj zgjidhjeje?

**Medi Bici:** Mediu është kundra.

**Brunilda Kadi:** E shikon që paska nevojë.

**Medi Bici:** {...} i përfundon mandati ditën që të iki nga Gjykata Administrative Shkodër.

**Marçela Shehu:** Atëherë, mendoj që ne pikërisht këtë duhet të votojmë: A biem të gjithë dakord që ne duhet të ndërmarrim këtë hap?

Unë të kuptoj Ilir që ne nuk disponojmë dot me një vendim formal për ta zgjidhur çështjen në substancë, pra nuk e zgjidhim ne zëvendëskryetarin, ne vetëm do të vlerësojmë që ne të ndërgjegjësojmë gjykatën që të marrë hapat ligjore. Mirëpo për sa kohë paska edhe vendime kundër në Këshill, atëherë duhet votuar dhe duhet vendosur...

**Ilir Toska:** Bëhemi shumicë, e nisim ose s'e nisim njoftimin.

**Marçela Shehu:** Okej! Por a mund ta diskutojmë këtu?

A është ky momenti për ta diskutuar? – Këtë po themi.

**Ilir Toska:** Ju e ngritët shqetësimin.

Të gjithë u bënë të ndërgjegjshëm që ka një shqetësim.

Mblidhemi, e bëjmë ose nuk e bëjmë atë njoftimin. Kaq është. Unë nuk di se çfarë të votoj.

**Brunilda Kadi:** Mund të bëj një propozim konkret?

T'i kërkohet asaj gjykate që trupa gjyqësore t'i komunikojë Këshillit caktimin e zëvendëskryetarit sipas akteve ligjore dhe nënligjore. Dhe ata kanë detyrimin si trupë gjyqësore, bazuar në këto akte, të caktojnë zëvendëskryetarin dhe t'ia njoftojnë Këshillit për të vijuar më tutje se cilin do njohë Këshilli si përfaqësues ligjor të gjykatës. Le ta hedhim në votë këtë formulimin me këtë thelb të njoftimit të kësaj trupe gjyqësore. Kush është kundër, le të thotë arsyetimin. Që të ecim tani.

**Ilir Toska:** Se ju po ngecni kot tani.

Vazhdon thua që kam propozim që t'i themi gjykatës që gjykata të na thotë.

**Brunilda Kadi:** Po mirë, si ta zgjidhim o Ilir?

Si ta zgjidhim situatën?

**Ilir Toska:** Zgjidheni jashtë mbledhjes.

Jemi të gjithë. Të themi të bëjmë këtë tekstin, do ia nisim njoftimin. Nuk do e nisim njoftimin. Dhe mbaron. Kaq.

**Brunilda Kadi:** Do votojmë nëpërmjet e-mailit?

**Ilir Toska:** Me çfarëdo lloj mjeti komunikimi, ne mund të bëjmë një draft dhe të biem dakord ose mund të mos biem dakord me atë draftin, apo të biem dakord me një gjë tjetër. Por nuk e di se çfarë vendimi të marrim në mbledhje plenare tani?!

**Brunilda Kadi:** Po pse kur jemi të mbledhur ne e bëjmë këtë gjë dhe pastaj formulojmë tekstin.

**Ilir Toska:** Thuaj vendimin, se nuk kuptoj vendimin.

**Brunilda Kadi:** Atë që do ta bëjmë me atë mënyrën tjetër të komunikimit, le ta zgjidhim tani.

**Ilir Toska:** Po vendimi në mbledhje plenare kush është? Mund të ma thuash?

**Brunilda Kadi:** Është dakordësi e Këshillit, me shumicë ose unanimitet, që të veprojmë kështu.

**Ilir Toska:** Këshilli është dakord që të diskutohet që të vendosi për një gjë në lidhje me njoftimin. Unë nuk e di a ka apo nuk ka kontestime. Nuk besoj që të ketë. Pastaj mund të ketë për zgjidhje.

**Brunilda Kadi:** Po ka pra kontestime.

Sapo tha zoti Bici që s'është dakord.

**Ilir Toska:** Zoti Bici ka pretendime për thelbin e kush do të jetë zëvendëskryetari. Nuk ka të bëjë me njoftimin që po diskutojmë ne.

**Marçela Shehu:** Atëherë, meqë u nis ky diskutim edhe që të jetë transparente deri në fund situata. Ka problem që secili nga ne le ta shprehë mendimin e vet për këtë situatë dhe ta quajmë një mënyrë të rëni dakord, për atë që do bëjmë në e-mail, ta bëjmë këtu. Atë formulim të njoftimit Ilir që do bëjmë në e-mail, le ta kalojmë këtu njëri pas tjetrit dhe le ta quajmë të kaluar.

**Ilir Toska:** Atëherë, ajo që mendoj unë është që në mbledhje plenare shqyrtohen çështje të mbledhjes plenare. Jashtë mbledhjes plenare, në mënyrë informale mblidhemi dhe vendosim gjithçka tjetër. Unë nuk di se çfarë vendimi duhet të marrë sot Këshilli, referuar shqetësimit që ju ngritët.

**Marçela Shehu:** Nuk është vendim, pra ramë të gjithë dakord Ilir që s'është vendim.

Mirë pra, atë diskutimin që e diskutojmë jashtë mbledhjes, që s'e bëjmë dot më edhe për shkak të kushteve të pandemisë, le ta ezaurojmë këtu. Ky është diskutimi. Hajde të themi të gjithë, që po, jemi dakord ta bëjmë njoftimin.

**Ilir Toska:** Mirë, vazhdojmë diskutojmë. E ke gati tekstin? Dhe pastaj, do marrim ndonjë vendim në fund të kësaj gjësë?

A jemi në mbledhje plenare tani, të lutem?

A duhet t'i qëndrojmë seriozitetit të mbledhjes plenare apo do rrimë të merremi edhe me ca çështje të tjera meqë dolën rrugës.

**Marçela Shehu:** Edhe kjo është shumë serioze. Nuk mendoj se është një çështje që doli në rrugë. Është një gjë shumë serioze. Por gjithsesi, mund ta procedojmë si ta mendoni, si ta vlerësoni të gjithë.

**Erjon Muharremaj:** Më fal zonja Kryetare, kam kërkuar fjalën me shkrim!

**Naureda Llagami:** Po Erjon, ke të drejtë.

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

E deklaroj qëndrimin tim në lidhje me këtë çështje që nuk do të marrë pjesë në votim, për sa kohë që nuk është kompetencë e mbledhjes plenare për t'u votuar. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Atëherë, a biem dakord të gjithë që nga ana e stafit administrativ do përpilohet një kthim përgjigje, e cila do konsultohet me të gjithë anëtarët dhe do i përcillet gjykatës. Kjo çështje nuk është një çështje e mbledhjes plenare dhe ne nuk mund të fusim çështje në mbledhje plenare pa qenë çështje në kuptim të ligjit. Kështu që, nga ana e administratës të hartohet një përgjigje, duke marrë parasysh rekomandimet e dhëna nga të gjithë anëtarët dhe më pas kjo t'i kalohet të gjithë anëtarëve dhe t'i përcillet gjykatës.

*Alban Toro:* Plotësisht dakord.

*Erjon Muharremaj:* Dakord.

\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.06.2020)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 17:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti **Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë tani tek çështja tjetër, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”. Edhe për këtë relator do të jetë zoti Alban Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

Më herët, me vendimin nr. 194, datë 04.06.2020 Këshilli ka vendosur hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për një afat deri në një vit. Kjo shpallje fillimisht i është drejtuar gjyqtares së transferuar, aktualisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, znj. {...}, e cila është ftuar për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

Konform aktit të Këshillit, vendimit nr. 23, datë 07.02.2019 “Mbi miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, Komisioni i është drejtuar gjyqtares duke i marrë pëlqimin dhe administruar pëlqimin përkatës si dhe i është drejtuar zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet

në lidhje me: ngarkesën e gjykatës të cilën drejton në përgjithësi; pasojat që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarës; si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari kërkohet të transferohet duke marrë në konsiderate efektet negative të shkaktuara nga ky transferim.

Në vlerësim të ngarkesës aktuale të gjyqtarit që ka shprehur pëlqimin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, fushën në të cilën mbulon, cenimin e funksionimit normal të kësaj gjykate, duke marrë parasysh organikën aktuale por edhe numrin e çështjeve të të dy gjykatave, ekzistencës së pozicionit të lirë të përkohshëm në të, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ju ka propozuar nëpërmjet një projektvendimi, dispozitivin e të cilit unë po e lexoj si më poshtë:

1. Gjyqtarës {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për një periudhë deri në 1 vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë nga data 22.06.2020.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës znj. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.



**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarës {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për një periudhë deri në 1 vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. 2. Efektet e këtij Vendimi fillojnë nga data 22.06.2020. 3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarës znj. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.06.2020)*

**Pika 9 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 17:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

## **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen e radhës e cila edhe kjo ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtares {...}. Sërish fjalën e ka zoti Toro.

**Alban Toro:** Faleminderit!

E njëjta praktikë/procedurë është ndjekur edhe për këtë gjyqtare.

Më herët, me vendimin nr. 195, datë 04.06.2020 “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë” Këshilli ka vendosur ndër të tjera hapjen e kësaj procedure si dhe kjo shpallje i drejtohet gjyqtares së transferuar, aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, znj. {...}, e cila të ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

Në këtë kuadër, Komisioni ka administruar pëlqimin e kësaj gjyqtareje për të vijuar më tej transferimin e përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, gjithashtu i është drejtuar zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat në lidhje me ngarkesën e gjykatës, pasojat që krijohen në gjykatë nga vazhdimi i transferimit të gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë si edhe një propozim mbi

periudhën maksimale për të cilën gjyqtarja kërkohet të transferohet duke marrë në konsiderate efektet negative të shkaktuara nga ky transferim.

Të gjitha aktet ju janë përcjellë edhe juve nëpërmjet e-mailit dhe në përfundim Komisioni ju propozon projektvendimin, në dispozitivin e të cilit ju propozon:

1. Gjyqtares {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 22.06.2020.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares znj. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar nga relatori dhe Komisioni?

Nëse jo, do kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtares {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. 2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 22.06.2020. 3. Njoftimin e këtij vendimi

gjqtares znj. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.06.2020)*

**Pika 10 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 17:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

## **RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin tjetër të radhës e cila edhe kjo ka të bëjë me përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Relator i të cilit është sërish zoti Toro. Për ju fjala zoti Toro!

**Alban Toro:** Faleminderit!

I njëjti “modus operandi” është përdorur edhe për gjykatën në fjalë e cila ka një pozicion të lirë të përkohshëm, nëpërmjet vendimit nr.195, datë 04.06.2020 nga ana e Këshilli është hapur procedura e transferimit të përkohshëm për pozicione të lira në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë për një afat deri në 1 vit. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit të transferuar, aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, z. {...}, i cili është ftuar për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

Mbasi është administruar pëlqimi i këtij gjyqtari është vijuar më pas me kërkimin e një opinioni zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë në lidhje me ngarkesën e gjykatës të cilën drejton, pasojat që krijohen për gjykatën nga vazhdimi i transferimit të gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si edhe një propozim mbi periudhën maksimale për të cilën gjyqtari kërkohet të transferohet duke marrë në

konsideratë efektet negative të shkaktuara nga ky transferim, gjithmonë në përputhje me vendimin nr. 23, 07.02.2019 “Mbi miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”.

Pas administrimit të këtyre të dhënave, të cilat janë bërë të ditur edhe Këshillit, nga ana e Komisionit është vlerësuar, përveç pëlqimit të dhënë nga gjyqtari, është marrë në konsideratë organika aktuale, numri i çështjeve që mbulojnë të dy gjykatat dhe për të garantuar një funksionim normal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, është përgatitur një projektvendim në dispozitivin e të cilit ju propozohet:

1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 22.06.2020.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim lidhur me përmbajtjen.

Përndryshe, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

*Maksim Qoku:* Dakord.

*Brunilda Kadi:* Dakord.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.



Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 vit, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. 2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 22.06.2020. 3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 11.06.2020)*

**Pika 11 e rendit të ditës me objekt:** Vijimi i shqyrtimit të çështjes në lidhje me problematikën e adresuar nga Presidenti i Republikës me Shkresën nr.1117/2 prot., datë 10.04.2020, lidhur me qëndrimin e mëtejshëm në detyrë të z. {...} si anëtar i Gjykatës së Lartë.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:40 dhe mbaroi në orën 17:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Illir Toska*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Dritan Hallunaj**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**

#### **RENDI I DITËS:**

11. Vijimi i shqyrtimit të çështjes në lidhje me problematikën e adresuar nga Presidenti i Republikës me Shkresën nr.1117/2 prot., datë 10.04.2020, lidhur me qëndrimin e mëtejshëm në detyrë të z. {...} si anëtar i Gjykatës së Lartë.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, e cila ka të bëjë vijimin e shqyrtimit të çështjes në lidhje me problematikën e adresuar nga Presidenti i Republikës me shkresën e datës 10.04.2020, lidhur me qëndrimin e mëtejshëm në detyrë të z. {...} si anëtar i Gjykatës së Lartë.

Siç jeni në dijeni, kjo çështje, nga ana e Këshillit, është trajtuar në seancat plenare të datave 27 prill dhe 5 maj. Në mbledhjen e datës 5 maj, pas diskutimeve nga ana e Këshillit është vendosur me shumicë votash që zotit {...} t'i përcillet praktika dokumentare lidhur me aktet/vendimet për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, si dhe e gjithë korrespondenca e Këshillit me Presidentin e Republikës, pas propozimeve të bëra për emërimin si gjyqtar të z. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

Më lejoni t'ju informoj që nga ana e zotit {...} janë përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor shpjegime shtesë, pasi ka konsultuar praktikën dokumentare, më datë 10.06.2020, shpjegime të cilat ju janë vënë në dispozicion dhe janë vënë në dijeni të gjithë anëtarët e Këshillit.

Gjithashtu, po në mbledhjen e datës 5, me vendim të Këshillit, është vendosur që t'i kërkohet një opinion mbi këtë çështje misioneve që asistojnë Këshillin, EURALIUS dhe Projektit të USAID “Drejtësi për të gjithë”.

Nga ana e partnerëve është kthyer përgjigje më datë 05.06.2020, e cila është shpërndarë për njohje të gjithë anëtarëve.

Për më shumë, zonja Llagami i jep fjalën anëtarëve lidhur me dokumentacionin e administruar i cili është përcjellë pranë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës si dhe të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Për procedurë, ftohet të flasë relatorja e çështjes znj. Marçela Shehu, lidhur me dokumentet shtesë që kanë ardhur dhe ftohen të gjithë anëtarët nëse kanë diskutime, përpara se të kalohet në çështjet që janë për votim nga ana e Këshillit.

***Marçela Shehu:*** Faleminderit, Kryetare!

Unë jam njohur me materialin, me përgjigjen që ka ardhur nga të dyja misionet, Misioni USAID dhe Misioni EURALIUS, si dhe me shpjegimet shtesë që kanë ardhur nga z. {...}, megjithëse unë nuk isha në pjesën e atyre anëtarëve që ishin dakord që të kërkoheshin këto shpjegime shtesë, gjithsesi unë jam njohur me to.

Lidhur me vlerësimin dhe qëndrimin tim, të dyja këto informacione, si informacioni i ardhur nga misionet, i cili faktikisht e lë në vlerësim dhe në çmim të Këshillit të gjithë situatën në fjalë, por edhe pretendimet dhe qëndrimi i z. {...}, nuk kanë ndikuar në atë që në vlerësimin tim është zgjidhja e situatës në rastin konkret.

Unë ju kujtoj qëndrimin tim si relatorë, e mbajtur në mbledhjen plenare të datës 5 maj (në qoftë se nuk gabohem sepse janë zhvilluar disa mbledhje lidhur me këtë tematikë), në atë mbledhje, me cilësinë e relatores kam shprehur mendimin tim duke konsideruar se mandati i zotit {...} ka përfunduar ligjërisht në vitin 2014, fakt ky që është konstatuar edhe nga Këshilli në momentin që ka nisur procedurat e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, nga radhët e jogjyqtarëve.

Në vlerësimin tim, në momentin e emërimit të tre gjyqtarëve të rinj të Gjykatës së Lartë, zotit {...} i ka mbaruar detyrimi kushtetues për të vijuar ushtrimin e funksionit deri në pritje të pasardhësit, në respektim të nenit 136 të Kushtetutës. Vetë Këshilli ka mbajtur

qëndrimin që tre gjyqtarët e rinj nuk zëvendësojnë nominalisht zotin {...}, por potencialisht secili prej tyre mund të zëvendësojë çdo mandat të mëparshëm. Theksojmë gjithashtu këtu që pozicioni i katërt i shpallur nga Këshilli lidhet me momentin e largimit të zotit {...}.

Gjithashtu, vlerësoj se mbarimi i detyrimit kushtetues të zotit {...} për të vijuar detyrën deri në emërimin e pasardhësit, nuk e implikon Këshillin me ndonjë vendimmarrje të caktuar, qoftë të karakterit substancial, qoftë të karakterit deklarativ apo konstataues, për sa kohë ligji nuk përcakton një detyrim të tillë.

Në vlerësimin tim, ashtu siç e kam shprehur edhe në mbledhjen plenare të datës 5 maj, i vetmi reagim institucional dhe ligjor që duhet të ketë Këshilli në këtë rast, është t'i bëjë me dije të drejtën që i njeh neni 62 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", për t'u caktuar në një pozicion nivel apeli dhe të shprehë vullnetin lidhur me këtë moment ligjor.

Ky ka qenë propozimi im që e kam shfaqur në mbledhjen plenare të datës 5 maj. I qëndroj të njëjtit vlerësim dhe propozim, duke bërë me dije që, të gjitha ato pretendime që ka parashtruar zoti {...} në fjalën e tij, nuk kanë ndikuar dhe nuk sjellin ndryshime në vlerësimin që unë i kam bërë rrethanave të faktit, si dhe në kuptimin dhe interpretimin që unë i bëj si ligjit "Për statusin..." ashtu edhe nenit 136 të Kushtetutës.

Përveç të gjithë këtyre fakteve, dua të bëj ndoshta një interpretim shumë të shkurtër të nenit 136 dhe konkretisht të pikës 1 dhe pikës 5 të këtij neni, duke evidentuar që në nenin 136 të Kushtetutës, gjyqtarët emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Kjo dispozitë, duke sanksionuar në mënyrë të qartë një kohëzgjatje të caktuar të mandatit kushtetues, përbën një nda faktorët që garantojnë pavarësinë e gjykatës. Zgjatja e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë (që në mendimin tim nuk mund të ketë zgjatje të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë), nuk mund të mbështetet në paragrafin 5 të nenit 136 të Kushtetutës sepse kjo dispozitë nuk rregullon zgjatjen e mandatit të gjyqtarit pafundësisht, aq më tepër një zgjatje për më shumë se 6 vjet mbi mandatin 9-vjeçar. Për të siguruar funksionimin normal të Gjykatës së Lartë, dispozita kushtetuese lejon qëndrimin në detyrë të gjyqtarit që i ka mbaruar mandati, deri në ardhjen e zëvendësuesit.

Lidhur me dhënien përgjigje pyetjes "Për sa kohë mund të qëndrojë në detyrë gjyqtari që i ka përfunduar mandati", pra paragrafi 5 i nenit 136 të Kushtetutës duhet të

interpretohet në lidhje të ngushtë me paragrafin 1 të po këtij neni. Pra vihen përballë dy standarde kushtetues, qëndrimi në detyrë deri në emërimin e pasardhësit dhe emërimi për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi.

Për ta përmbledhur, në rastin konkret, në situatën e zotit {...}, qëndrimi i tij në detyrë përtej mandatit 9-vjeçar, për një periudhë tashmë mbi 6-vjeçare, na cenon dhe vë në rrezik edhe respektimin e parimit kushtetues të vendosur në pikën 1 të nenit 136 të Kushtetutës, e cila thotë që gjyqtarët e Gjykatës së Lartë rrinë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Kështu që, qëndrimi në detyrë deri në pritje të pasardhësit, ne duhet ta shikojmë dhe ta vlerësojmë brenda një kufiri të arsyeshëm kohëzgjatjeje. Pra kjo kohëzgjatje të jetë e tillë sa, t'i lërë mundësi organeve kompetente, në rastin konkret Këshillit, që të bëjë funksionale, me aq sa është e mundur, Gjykatën e Lartë.

Ne tashmë ia kemi arritur. Aktualisht në Gjykatën e Lartë ushtrojnë funksionin 3 gjyqtarë, që nga data 13 mars kur ata u dekretuan. Në këtë mënyrë, mendoj që, në përputhje me parimet dhe standardet e qarta kushtetuese të vendosura në pikën 1 dhe 5 të nenit 136, zotit {...} i ka mbaruar detyrimi kushtetues për të pritur pasardhësin e tij, duke qenë se pasardhësi tashmë ka vajtur (që është secili nga tre anëtarët që ushtrojnë funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë) dhe zotit {...} duhet t'i bëhet me dije nga Këshilli e drejta për të zgjedhur një pozicion në nivel apeli, ashtu siç përcakton neni 62 i ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Ky është qëndrimi im që është mbajtur edhe në mbledhjen plenare të datës 27 prill edhe në mbledhjen plenare të datës 5 maj, duke mos arritur në një përfundim apo në një mendim ndryshe, me gjithë vlerësimin që i kam bërë fakteve dhe interpretimit të ligjit dhe Kushtetutës që ka bërë zoti {...} në pretendimet e tij. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit zonja Shehu!

Atëherë, ndonjë koleg tjetër lidhur me çështjen?

Po, zoti Toro!

**Alban Toro:** Faleminderit!

Natyrisht, nuk po merrem me mendimin e paarsyetuar të gjyqtarit {...} kundër pushtetit gjyqësor sepse nuk shoh ndonjë argument të vlefshëm për të vazhduar debat

juridik në lidhje me të, për më tepër kur ai merret edhe me marrëdhëniet ndërinstucionale që Këshilli i Lartë Gjyqësor mban me institucione të tjera kushtetuese. Është një kompetencë që nuk besoj se mund ta gjej me ndonjë literaturë juridike për të cilën zoti {...} do të ishte kompetent për ta trajtuar.

Gjithsesi, kam mbajtur opinionin, domethënë më ka shqetësuar opinionin që KLGJ-ja duhet të shkëputet nga “Sindroma e Stokholmit” apo “instituti i heshtjes” sepse është një qëndrim në detyrë tej mandatit kushtetues; cenon parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë që duhet të ketë gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës; dhe në këtë kontekst ne kemi detyrimin që ta administrojmë këtë pushtet, në mënyrë që ai të jetë sa më efikas.

Nëse do t’i referohemi fakteve, nga 7 anëtarë të ardhur nga radhët e gjyqtarëve, vetëm 2 prej tyre, z. {...} dhe z. {...}, vijonin ushtrimin e detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Zoti {...} gëzonte mandatin e plotë deri në vitin 2021, ndërsa z. {...} i kishte mbaruar mandati, por vijonte të ushtronte funksionin deri në zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër.

Deri në këtë moment, KLGJ me miratimin e vendimeve nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019 kishte shpallur tre vakanca, duke përfshirë këtu edhe gjyqtarin që vijonte të ushtronte funksionin z. {...}. Me vendimin nr. 19, datë 26.07., Kolegji i Posaçëm i Apelit ndryshoi vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duke shkarkuar zotin {...}. Në këtë moment, u detyruam që me vendimin nr. 172, datë 11.09.2019 “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur” të fillonim procedurën për plotësimin e pozicionit të katërt dhe të fundit që ishte i hapur që vinin nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë. Kjo do të thotë që, që me datën 12 shkurt ne duhet të kishim marrë një vendim në lidhje me konkurrentin e fundit të katërt dhe ndoshta do t’i ezauronim z. {...} edhe argumentin e fundit që “unë kam të drejtë të qëndrojë mbasi të plotësohet edhe ky vend”. Ndonëse fakti është ndryshe, për të mos thënë edhe ligji ka trajtuar ndryshe, vepron në kundërshtim me opinionin që ka zoti {...} për të vijuar të ushtronte funksionin e tij me mandat që i kapërcen të gjithë afatet e mundshme.

Neni 179 tek dispozitat kalimtare të fundit të Kushtetutës, përcakton se: “Anëtarët e Gjykatës së Lartë vazhdojnë të ushtrojnë detyrën e tyre sipas mandatit të mëparshëm. Anëtarët e rinj që do të zëvendësojnë anëtarët të cilëve po i mbaron mandati, emërohen

sipas dispozitave të këtij ligji”. Kjo do të thotë që nëse kushtetutbërësi do të kishte pasur si qëllim që këta anëtarët e vjetër të vazhdonin të ushtronin funksionin, ai padyshim do të fuste dhe do të përfshinte të njëjtën frazë, siç ka përfshirë në nenin 136, pika 5 ku: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit”. Një mungesë e tillë do të thotë që edhe kushtetutbërësi nuk ka pasur si qëllim që të vazhdohet të ruaj të njëjtën skemë si në Gjykatën e Lartë të re, që ajo ka vijuar me formën e re.

Kështu që, përfundimisht edhe unë jam në mënyrë që Këshilli duhet të shprehet konform nenit 136/5, 139/1/b, 139/2 dhe 147/1 e Kushtetutës të konstatojë përfundimin e detyrimit për të ushtruar funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë z. {...}, për shkak të emërimit të pasardhësit të tij. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit zoti Toro për fjalën!

Ndonjë koleg tjetër lidhur me çështjen?

Zonja Ukperaj, fjala për ty!

***Brikena Ukperaj:*** Faleminderit zonja Kryetare!

Dëgjova diskutimin edhe të zonjës Shehu edhe të zotit Toro.

Në fakt, zoti Toro, mu duk, ose ishte perceptimi im, kontradiktor sepse pranon që mandati i anëtarëve të Gjykatës së Lartë të emëruar para hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese do të vazhdonte sipas mandatit të mëparshëm dhe ndërkohë, legjitimon qëndrimin në detyrë deri në momentin e emërimit të tre anëtarëve të rinj. Nëse do të ishte ky mendimi i zotit Toro, që në momentin e konstituimit, në momentin më të parë të marrjes në diskutim të çështjes për 5 anëtarët e tjerë të Gjykatës së Lartë që ishin larguar nga detyra, në momentin më të fundit kur ne i propozuam Presidentit të Republikës për dekretim tre emra, të paktën duhet ta kishte ngritur si shqetësim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky është perceptimi im personal.

Lidhur me çështjen. Deri tani si Këshill, ka një vendim të shprehur, por indirekt me vendime të ndryshme, duke filluar me komandimet në Gjykatën e Lartë (jo komandimet sepse nuk është termi i duhur ligjor) ose me caktimet e gjyqtarëve nga gjykatat e tjera për të plotësuar trupat gjykues, me shqyrtimin e çështjeve të tjera që kanë lidhje me Gjykatën e Lartë, e të tjera si këto, kemi legjitimuar qëndrimin në detyrë të zotit



{...}, deri në momentin kur i kemi propozuar Presidentit për dekretim emrat e tre gjyqtarëve. Jo vetëm deri në këtë moment, por edhe më pas. Ne kemi nënshkruar një Memorandum, para se të miratonim vendimin përfundimtar, ku zoti {...} ishte firmëtar në këtë Memorandum dhe në atë moment asnjëri nuk e ngriti si diskutim. Asnjëherë nuk e kemi diskutuar në mbledhje plenare, qoftë edhe si një propozim që mund të vinte nga ndonjë nga Komisionet, nëse Komisioni i Karrierës nuk e ka sjellë si propozim, për të shpallur ndonjë vend vakant dhe për të filluar një procedurë të ndërprerjes së qëndrimit në detyrë të zotit {...}, me qëllim që, në momentin kur të tre apo ndonjëri nga anëtarët e Gjykatës së Lartë të shkonte në detyrë, zoti {...} të shkonte ditën tjetër, nëse ai do ta ushtronte të drejtën e zgjedhjes, në gjykatat e apelit. Pra kjo është një situatë “post factum”, për të cilën jemi vënë në lëvizje nga një shkresë e dërguar nga Presidenti i Republikës.

Pse unë vet si anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk e kam marrë këtë iniciativë? – Sepse kam vlerësuar që, si në momentin kur kemi përgatitur përgjigjen e shkresës për Presidentin e Republikës dhe në çdo vendimmarrje që ka ndjekur procedurën e emërimit të anëtarëve në Gjykatën e Lartë, pasardhësi i zotit {...} nuk ishte as i pari, as i dyti, as i treti, por do të konsiderohej, për efekt të Kushtetutës dhe të ligjit, anëtari i katërt që do të shkonte në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur.

Pse kam patur këtë mendim? – Referuar nenit 136 të Kushtetutës, gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh””. Këto nënparagrafë thonë: “1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbaron në rastet e mëposhtme: [...] c) jep dorëheqjen; ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 140 të Kushtetutës; d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën”. Pra, mbarimi i mandatit nuk passjell mbarimin e qëndrimit në detyrë për anëtarin e Gjykatës së Lartë, nëse nuk ka shkuar pasardhësi.

Çfarë parashikon tjetër kushtetuta? – Parashikon që procedura për emërimin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër pas përfundimit të mandatit rregullohet me ligj (neni 139/3), dhe në këtë mënyrë parashikon një rezervë ligjore se si do të rregullohet procedura për emërimin e gjyqtarit që i ka mbaruar qëndrimi në detyrë në një gjykatë tjetër dhe që janë

nenet pikërisht 61 dhe 62 të ligjit “Për statusin...”.

Në dispozitat kushtetuese gjejmë një linjë të tillë të zhvillimit të karrierës për gjyqtarët që kanë qenë në detyrë në Gjykatën e Lartë, por edhe për gjyqtarët e tjerë, që fillon me mbarimin e mandatit, qëndrimin në detyrë (nëse nuk ka shkuar pasardhësi) dhe emërimin në një gjykatë tjetër.

Duke iu referuar procedurave të parashikuara në nenin 61 dhe në nenin 62 të ligjit “Për statusin...”, fryma e ligjvënësisë, sikundër edhe e kushtetutbërësisë ka qenë e tillë që, asnjë pozicion vakant të mos qëndrojë si i tillë në Gjykatën e Lartë. Pra, plotësimi i pozicioneve në Gjykatën e Lartë, dhe jo zëvendësimi i gjyqtarëve, ndjek parimin e funksionalitetit të organit dhe jo atë të zëvendësimit nominal, sikurse ndodh me Gjykatën Kushtetuese

Në dispozitat tranzitore të Kushtetutës parashikohet në mënyrë të shprehur se si do të ndodhë zëvendësimi i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Ndërkohë, për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kushtetuta nuk parashikon një gjë të tillë. Edhe në dispozitat kushtetuese, edhe në dispozitat ligjore, është fryma e parimit të funksionalitetit të Gjykatës së Lartë. Në asnjë dispozitë nuk gjejmë një parashikim të tillë që, z. {...} do të zëvendësohen nga anëtari i parë, nga anëtari i dytë, nga anëtari i tretë. Edhe në letrën që i kemi dërguar Presidentit të Republikës, në përgjigjen (më saktë) që i kemi dërguar, kemi thënë: “Tre kandidaturat e propozuara për emërim nuk i korrespondojnë ndonjë pozicioni të lirë që lidhet nominalisht me gjashtë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilëve iu kishte mbaruar mandati para datës 09.07.2019. Sa më lart u parashtrua, asnjë nga tre kandidatët e propozuar për emërim nuk zëvendëson nominalisht gjyqtarin {...}”. Nuk kemi thënë që potencialisht, secili prej tyre, mund ta zëvendësojë zotin {...}. Unë, kur e kam votuar përmbajtjen e kësaj shkrese, kam votuar pikërisht për shkak të këtij parashikimi sepse kam vlerësuar vet që detyrimi i zotit {...} për të qëndruar në detyrë përfundon kur shkon anëtari i katërt dhe sepse në çdo rast, për të garantuar ruajtjen e funksionalitetit të Gjykatës së Lartë, asnjëherë nuk mund të ketë më shumë se 1/5 anëtarë të gjykatës që vijnë nga juristët e spikatur.

Në dispozitat tranzitore të ligjit “Për statusin...” parashikohet që anëtarët që janë zgjedhur në Gjykatën e Lartë, sipas dispozitave të mëparshme, nga Kuvendi, do të gëzonin statusin e gjyqtarit të zgjedhur nga juristët e spikatur. Si e tillë, pavarësisht

numrit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, jo më shumë se  $\frac{1}{4}$  e tyre mund të ishin juristë të spikatur. Në këtë rast, sot në detyrë kemi 4 anëtarë të Gjykatës së Lartë, të ardhur nga juristët e spikatur.

Për këtë shkak, vlerësoj që, detyrimi i zotit {...} për t'u larguar nga detyra apo për të ndërprerë qëndrimin në detyrë, përfundon në momentin kur shkon anëtari i katërt. Edhe për një arsyetim tjetër. Rikonceptimi i Gjykatës së Lartë solli një ndryshim në mënyrën e plotësimit të pozicioneve por edhe për shkak të numrit të anëtarëve.

Para hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, numri i anëtarëve të Gjykatës së Lartë ka qenë 19, nga të cilët (në mos gabohem) 7 kanë qenë të zgjedhur nga ana e juristëve të spikatur. Këta 7 anëtarë, me frymën e re kushtetuese dhe me parashikimet kushtetuese, u zëvendësuan me 4 anëtarë. Nga ana tjetër, Kushtetuta parashikoi që zëvendësimi i vendeve vakante do të bëhet për pozicione specifike, pra nuk do bëhet për anëtarë. Për shkak të këtij parashikimi, unë vlerësoj që nuk lidhet nominalisht emri i zotit {...} me një zëvendësim që mund të vijë, që ka ndodhur ose që do të vinte në Gjykatën e Lartë, për të plotësuar vetëm tre anëtarë, por do duhej që në të gjitha rastet, për shkak të funksionalitetit të Gjykatës së Lartë, të garantonim që të kishim në detyrë 4 anëtarë nga radhët e juristëve të spikatur.

Lidhur me arsyetimin e bërë nga zonja Shehu, për një emërim faktik të zotit {...}, për sa i përket lidhjes dhe mënyrës se si duhet të ndërthuret arsyetimi i nenit 136/1 me nenin 136/5 të Kushtetutës (edhe pse i gjithë arsyetimi i zonjës Shehu ishte me një mendim pakice të Gjykatës Kushtetuese, që e ka marrë në shqyrtim një çështje analoge, për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese) unë vlerësoj se qëndrimi në detyrë i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, deri në emërimin e pasardhësit, nuk është riemërim, as nuk është zgjatje mandati, është pikërisht detyrim për të garantuar funksionalitetin e Gjykatës së Lartë; është për shkak sepse plotësimi i pozicioneve në Gjykatën e Lartë ndjek parimin e funksionalitetin dhe ajo atë të nominalitetit.

Prandaj, për këtë shkak dhe për çka relatova dhe arsyetova, vlerësoj që detyrimi i zotit {...} për të qëndruar në Gjykatën e Lartë nuk ka mbaruar, por mbaron në momentin kur aty shkon anëtari i katërt gjyqtar, i zgjedhur nga radhët e juristëve të spikatur, pra kur do të shkojë kandidatura e katërt që ne kemi në proces dhe të shpresojmë që do ta mbarojmë sa më shpejt. Faleminderit!

**Alban Toro:** Mundem? Sepse më tha kontradiktor Brikena dhe nuk e kuptova.

Në lidhje me pjesën e kontradiktoritetit. Besoj që nuk jam i tillë. Jam munduar të jem një komponent i KLGJ-së, sepse nuk jam KLGJ-ja, me të gjithë format dhe mënyrat, të sensibilizoj faktin që qëndrimi në detyrë, tej mandatit kushtetues, është i rrezikshëm, në shumë aspekte. Kështu që në këtë kontekst, jo vetëm në diskutimin që është bërë në raport me atë që ka ngritur shqetësim Presidenti, por edhe në institucione të tjera, siç është ai i Komisionit të Përkohshëm për Marrëveshjen në Gjykatën e Lartë, ku fillimisht zoti {...} ishte në kundërshtim dhe nuk pranonte që të krijohej apo të kërkohej një ndihmë e tillë. Më pas, nga ana e Komisionit iu sqarua dhe pranoi faktin të bashkëpunonte në lidhje me këtë pjesë. Nëse do të kishte ndjekur minutat që janë mbajtur në këtë Komision, ndoshta do ishte sqaruar edhe për këtë aspekt zonja Brikena.

Nëse do ishte në detyrë zoti {...}, do të flitej më për çështjen {...} apo jo? – Kjo është pyetje që i bëj Brikenës.

**Brikena Ukperaj:** Vet, ke një përgjigje për këtë, Alban?

**Alban Toro:** Patjetër që zotit {...} i është ezauruar...

Përgjigjen time ta kam dhënë Brikena. Zoti {...} ka pasur detyrimin, të drejtën për të qëndruar, kur janë emëruar tre gjyqtarët që ne dërguam në Gjykatë të Lartë.

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, unë po ta jap përgjigjen.

Unë arsyetimin e vendimit e mbështeta në konkluzionin që, për sa kohë Gjykata e Lartë në asnjë moment nuk mund të ketë më shumë se 1/5 anëtarë jogjyqtarë, që vijnë nga juristë të spikatur, nëse sot zoti {...} do të ishte në detyrë dhe do ishte brenda mandatit, zotit {...} i kishte përfunduar qëndrimi në detyrë sepse tre të rinj dhe zoti {...} (katër), më shumë se katër nuk do të kishte mundësi. Por fakti që ne shpallëm më vonë zotin {...} nuk do të thotë se pozicioni i katërt është i zotit {...}. Jo, pozicioni i katërt është një mundësi që të emërohet një anëtar tjetër jogjyqtar në Gjykatën e Lartë.

**Brunilda Kadi:** Dhe i bie Brikena, që pasardhësi i zotit {...} është...?

**Brikena Ukperaj:** Pasardhësi i zotit {...} është anëtari i katërt jogjyqtar që zgjidhet nga radhët e juristëve të spikatur dhe që shkon në pozicionin e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë.

**Brunilda Kadi:** Dhe këtë ti e bazove tek neni...? Tek cili nen?

**Brikena Ukperaj:** Tek të gjitha nenet që analizova Bruna, në qoftë se ti nuk dëgjove.

**Brunilda Kadi:** Jo, jo! Të dëgjova me shumë vëmendje. Por humba sepse nuk kuptova asnjë gjë me thënë të drejtën nga ato që the.

**Brikena Ukperaj:** Nuk më kuptove?

**Brunilda Kadi:** Sepse nuk më bënte lidhje pjesa e parë, faktit, argumentat me konkluzionin dhe me thënë të drejtën, nuk të kuptova fare.

**Brikena Ukperaj:** Po, faleminderit! Dëgjoje në ritransmetim.

**Brunilda Kadi:** Jo, jo! Të dëgjova, por nuk të kuptova. Se nuk më bënë lidhje gjërat.

Mundem të marrë fjalën?

**Naureda Llagami:** E ke marrë Bruna, vazhdo!

**Brunilda Kadi:** Thjesht ishte një ndërhyrje, por në qoftë se ka kërkuar dikush tjetër.

**Naureda Llagami:** Ti nuk pyet për leje fjale, kështu që ti ndërhysh direkt. Kështu që e ke marrë, vazhdo argumentin!

Më tej, merr fjalën zonja Kadi.

**Brunilda Kadi:** Faleminderit!

Së pari, në lidhje me faktet që referoi zonja Ukperaj. Së pari, unë qëndrimin tim publik, të qartë e kam bërë në datën 16 prill 2020, në mbledhjen plenare.

Duhet të sqaroj që çështja nuk është sjell për diskutim në mbledhje plenare si një çështje e kërkuar nga Presidenti i Republikës.

Siç ju kam sqaruar në atë mbledhje, unë dhe zoti Toro, si dy nga tre anëtarët e Komisionit të Përkohshëm, të ngritur nga Këshilli për miratimin e një plani masash për mënyrën se si do të veprohet për uljen e çështjeve të prapambetura në Gjykatën e Lartë,

disa ditë përpara seancës, kemi rënë në dijeni të faktit që, nëpërmjet komunikimeve me e-mail nga Misionet, që ftoheshin pjesëmarrësit e Memorandumit (tani unë po flas për të gjithë anëtarët që i kanë parasysh të gjitha faktet) që do firmoseshe nga zoti {...}, dhe bëhet fjalë për fundin e marsit. Neve sapo kishim hyrë në periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore nëpër gjykata, por edhe të veprimtarisë tonë si Këshill dhe komunikim nëpërmjet e-maileve apo edhe më vonë filluam që të bënim edhe mbledhjet plenare nëpërmjet platformës “online”.

Kemi komunikuar me Projektin “Justice for All” dhe kemi ngritur shqetësimin tonë në lidhje me legjitimitimin e zotit {...} dhe kemi diskutuar që këtë çështje do ta parashtronim në Këshill dhe do e zgjidhnim përpara datës 17 prill, që ishte caktuar për t’u nënshkruar formalisht marrëveshja. Në seancën e datës 16 prill 2020, në orën 01:39 të mëngjesit, nga ana e Kryetares së Këshillit, siç e kam relatuar, na vjen një mesazh në “e-mail” zyrtar në lidhje me shpresën e cituar/e dërguar nga institucioni i Presidentit të Republikës, i cili nuk i drejtohet me kërkesë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për saktësi, e ka për dijeni. Shkresa nuk na dërgohet ne, i dërgohet (me sa mbaj mend) tre anëtarëve të Gjykatës së Lartë, të zgjedhur, të rinj, dhe me sa mbaj mend Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Ne ishim për dijeni.

Unë e kam cituar këtë shkresë vetëm si shqetësim dhe kam thënë “unë për veten time marr këtë “e-mail” në këtë orë të mëngjesit nga Kryetarja e Këshillit, e vlerësova që duhet të ishte shqetësim nga ana e saj, dhe thjesht e kam cituar. Pra për të shpjeguar të gjithë historinë se si ka ndodhur sjellja e çështjes në tavolinë.

Për t’i kujtuar zonjës Ukperaj, që ne me “post factum” kemi legjitimuar zotin {...}. Së pari, nëse kemi legjitimuar, nuk e kuptoj zonja Ukperaj propozimin tuaj, që ky është një proces administrativ dhe ne duhet t’i komunikim të gjithë procedurën zotit {...}, sikundër unë ju kam kundërshtuar në atë mbledhje, dhe kam thënë që ky nuk është një proces administrativ por është një veprim administrativ. Për mua këtu nuk ka kazus juridik, si juriste, jo më si gjyqtare dhe anëtare e Këshillit. E kam shprehur mendimin tim qartë në mbledhjen e datës 16 prill.

Po ritheksoj, në datën 13 mars, kur ne kishim një ditë që kishim pezulluar veprimtarinë tonë si Këshill i Lartë Gjyqësor dhe një ditë më përpara, në mos gabohem, kishim pezulluar veprimtarinë e gjykatave, bie në dijeni nëpërmjet mediave, që u betuan

përpara Presidentit të Republikës, tre anëtarët e rinj të Gjykatës së Lartë, të propozuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Ishte situata e gjendjes së jashtëzakonshme, të gjithë sapo kishim hyrë, asgjë nuk funksiononte dhe me sa kam unë informacionin, nga data 13 mars nuk është bërë asnjë veprim (se s’kishte si të bëheshe), qoftë nga Gjykata e Lartë, qoftë nga Këshilli. Unë vet personalisht si anëtare, nisur nga e gjithë situata faktike dhe juridike, kam vlerësuar që zotit {...}, në datën 13 mars, duke e konsideruar veten jogjyqtar të asaj gjykate, ka kryer veprimet administrative të dorëzimit të detyrës. Bie në dijeni të faktit që kjo gjë nuk ka ndodhur, vetëm kur është dërguar e-mail nga përfaqësuesja e Projektit “Justice for All”, ku thuhej që ftoheshin përfaqësuesit për të nënshkruar Marrëveshjen e Mirëkuptimit me këtë Projekt, midis nesh, Gjykatës së Lartë dhe Projektit. Edhe të mos e përsëris se çfarë ndodhi.

Pra nuk ka ndodhur asnjë “post factum” që ne kemi legjitimuar veprimet e zotit {...}.

Qëndrimin tim unë e kam mbajtur, thjesht po e përmbledh. Unë mendoj që në datën 13 mars, në momentin që është betuar, jo njëri nga gjyqtarët, por gjyqtari i parë që është betuar përpara Presidentit të Republikës dhe që shënon fillimin e funksionit në detyrë të atij gjyqtari, zotit {...} i ka mbaruar, jo detyrimi – dua të saktësoj, ndoshta edhe anëtarët e tjerë që mendojnë që është detyrim – por e drejta dhe mundësia që zotit {...} të qëndrojë në detyrë dhe nuk mund ta ushtrojë atë detyrë. E them këtë, dhe e kam sqaruar në atë mbledhjen e mëparshme, edhe sikur në Gjykatën e Lartë sot të ishin të gjithë gjyqtarët që vinin nga jashtë gjyqësorit, por që dhanë dorëheqjen diku para 1 viti, të vazhdonin të rrinin në detyrë duke pritur pasardhësin, dhe ne si Këshill të kishim sukses të kishim çuar vetëm një gjyqtar në Gjykatën e Lartë, i pari që duhet të largoheshe ishte zoti {...}, nisur nga një logjikë e thjeshtë, sepse është gjyqtari që ka më të gjatë momentin kur i ka mbaruar mandati dhe me sa mbaj mend është diku shkurt 2014. Gjyqtarëve të tjerë mbas zotit {...}, i mbaronte mandati më vonë. Pra me një logjikë të thjeshtë minimaliste, unë mendoj që funksionon kështu.

Tani, në lidhje me shprehjen “detyrim kushtetues”, që me sa e lexova nga qëndrimi i zotit {...}, mendoj se është i tillë, ai mendon se është detyrim kushtetues të presë pasardhësin (në fakt nuk e përmend fjalën “pasardhës” as gjëkund në qëndrimin e tij, çuditërisht, dhe asnjë dispozitë ligjore ku e mbështet qëndrimin e tij) por fjala

“detyrim”, ju kujtoj që sipas legjislacionit shqiptar, puna e detyruar është e ndaluar në Shqipëri. Kështu që zoti {...} nuk mund të pretendojë se është i detyruar që të rrijë aty. Sepse nëse e pranojmë këtë gjë, përveçse është në kundërshtim me çdo lloj koncepti ligjor... ne duhet të kishim ndërmarrë veprime për gjyqtarët e tjerë që s’e kanë përmbushur këtë detyrimin kushtetues. Kemi 5 gjyqtarë që na dhanë dorëheqjen para 1 viti. Kështu që mendoj që nuk jemi përpara detyrimit kushtetues.

Dhe e fundit, siç unë kam mbajtur qëndrim për gjyqtarët që sapo citova, sipas mendimit tim juridik, bazuar në nenin 62 të ligjit “Për statusin...”, të drejtën për t’u caktuar në një pozicion apeli, nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, që iu ka mbaruar mandati 9-vjeçar, mendoj që e kanë vetëm ata që plotësojnë kriteret për të shkuar në atë pozicion, dhe nëse Këshilli do vijë në këtë moment, unë do kërkoj që të verifikohet nëse zoti {...} i plotëson kriteret për atë pozicionin e apelit që do t’i ofrohet për të shkuar. Ligji thotë shprehimisht që ai caktohet nëse plotëson kriteret për atë pozicion.

Për ta bërë më të thjeshtë për ata që dëgjojnë, do të thotë që, për të shkuar për shembull në gjykatën e apelit me juridiksion të përgjithshëm, gjyqtari duhet të ketë, në eksperiencën e tij, 7 vite si gjyqtar në shkallën e parë. Nëse do të jetë në apelin e Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka kriteret të tjera të posaçme. Por kjo i përket momentit kur Këshilli do vendosë që të marrë këtë vendim.

Kjo ishte për të përmbledhur të gjithë qëndrimin tim gjatë gjithë kësaj kohe në lidhje me këtë çështje. Faleminderit!

Merr fjalën zonja Marçela Shehu.

**Marçela Shehu:** Atëherë, në fakt do doja të replikoja diçka të shkurtër me Brikenën. Nga fjala e saj unë kuptova që mendimi im përkonte me një mendim pakice të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, që unë nuk e di cili është ky vendim dhe ky mendim, për fatin tim të keq, sepse do ishte mirë që të kisha lexuar më shumë ndoshta nga jurisprudenca e kësaj gjykate. Gjithsesi unë do doja që ne të vinim theksin tek mendimi, vlerësimi dhe interpretimi që ne duhet t’i bëjmë Kushtetutës dhe ligjeve dhe jo të vëmë theksin dhe të hulumtojmë tek analizat juridike personale që gjithsecili bën nga ne.

Duke iu rikthyer edhe një herë asaj që unë theksova që në fillim. U mora pak me



nenin 136 të Kushtetutës, konkretisht me pikën 1 dhe 5, duke dashur, brenda mundësive të mia modeste, ligjore, të bëj një interpretim të këtyre dy pikave në lidhje me njëra-tjetrën.

Kushtetuta në pikën 1 të nenit 136 thotë që gjyqtarët emërohen në Gjykatën e Lartë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Ndërsa në pikën 5, thotë që gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në këtë detyrë deri në pritje të pasardhësit. Ajo çka unë theksova ishte që ne duhet të respektojmë, duhet të sigurohemi për zbatimin e secilës pikë të kësaj dispozite, të nenit 136, pa cenuar pikën tjetër. Pra gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të qëndrojë dhe duhet të qëndrojë në detyrë deri në pritjen e pasardhësit, por ky afat pritjeje, kjo periudhë pritjeje nuk mund të kalojë çdo limit të arsyeshëm, që në vlerësimin tim përkon me një mandat të dytë të gjyqtarit, duke cenuar kështu pikën 1 të nenit 136, që thotë që gjyqtari i Gjykatës së Lartë mund të rrijë në këtë detyrë 9 vjet, jo 18. Ne po hyjmë në vitin 16-17 të ushtrimit të detyrës nga zoti {...}. Unë për këtë jam personalisht e shqetësuar si gjyqtare, si anëtare e Këshillit, si përgjegjëse, për të ruajtur mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor dhe legjitimitetin institucional të Këshillit dhe të gjithë sistemit.

Unë mendoj që zoti {...}, në momentin që emëruam tre gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, më datë 13 mars, i mbaroi detyrimi kushtetues, në përputhje me pikën 5 të nenit 136 të Kushtetutës. Faleminderit, Kryetare!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, Marçela!

Po, Erjon!

Merr fjalën zoti Erjon Muharremaj.

***Erjon Muharremaj:*** Faleminderit, zonja Kryetare!

Në vijim të diskutimeve të mëparshme të kolegëve, nuk arrita të kuptoj qëndrimin e zotit Toro në lidhje me “Sindromën e Stokholmit”, se për ato njohuri që kam unë nga fusha e psikologjisë, është një varësi psikologjike e viktimës me abuzuesin dhe nuk e di, nuk kam perceptuar ndonjë abuzim karshi KLGJ-së në momentin që ai fton kolegët e Këshillit që të çlirohen nga kjo sindromë.

Gjithashtu, nuk arrita të kuptoj edhe nga fjala e zonjës Kadi çështjen e punës së detyruar për gjyqtarin {...}, sepse referuar Konventës mbi punën e detyruar, përkufizimi i

punës së detyruar përcakton që, punë e detyruar është puna apo shërbimi i cili përftohet nga një person nën kërcënimin e ndëshkimit dhe për të cilin personi nuk ka ofruar që ta kryejë vullnetarisht. Kështu që nuk arrita të bëj lidhjen me punën e detyruar nga ana e gjyqtarit {...}.

Në gjykimin tim, gjyqtari {...} ka pasur detyrimin kushtetues për të vijuar ushtrimin e detyrës së tij në respektim të parimit të vazhdimësisë institucionale dhe funksionale të Gjykatës së Lartë, në mënyrë që të vijonte procesi i dhënies së drejtësisë, proces që në gjykimin tim është thelbësor në një shtet të së drejtës. Dhe kjo nuk është e drejtë, por detyrim për gjyqtarin, në mënyrë që ai të vazhdojë të japë drejtësi, si mision i tij, në zbatim të normave të shprehura në Kushtetutë, në ligje dhe në akte të tjera ligjore, për të garantuar shtetin e së drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Shqetësimi që unë kam në lidhje me vijimin e ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarit {...}, lidhet me atë çka jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut e ka cilësuar si çështje që lidhet me ushtrimin e detyrës nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, ku kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë e ka konsideruar si një ndër elementët esenciale për paanësinë dhe pavarësinë...

**Brunilda Kadi:** ... dhe të caktuar në ligj.

**Erjon Muharremaj:** Më falni zonja Kadi, unë nuk ju ndërpreva ndërkohë që ju po flisnit. Nëse keni diçka urgjente, unë mund ta ndërpres fjalën, që ta merrni juve. Por unë nuk ju ndërpreva dhe minimalisht kërkoj dhe të njëjtin respekt nga ana juaj. Po nëse keni diçka urgjente, unë po ndaloj dhe vazhdoni juve.

**Brunilda Kadi:** Jo, keni shumë të drejtë zoti Muharremaj. Ju kërkoj shumë ndjesë.

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

Mund të vazhdoj zonja Kryetare?

**Naureda Llagami:** Po, zoti Muharremaj!

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

Pra i referohem këtu çështjes “Oleksandr Volkov kundër Ukrainës” (vendimi me nr. 21722/11), në paragrafin 103, ku gjykata shprehet: “Për të përcaktuar nëse një gjykatë mund të konsiderohet e pavarur në kuptim të nenit 6/1 të Konventës, ndër të tjera duhet mbajtur parasysh mënyra e emërimit të gjyqtarëve, kohëzgjatja në detyrë dhe ekzistenca e

garancive kundër presionit të jashtëm dhe nëse trupa edhe në dukje paraqitet si e pavarur.”

Gjithashtu, unë gjykoj që, vijimi i ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, z. {...}, është çështje që ka të bëjë edhe me të drejtën e individit, që çështja e tij të gjykohet jo vetëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme por edhe nga një gjykatë e krijuar me ligj, në kuptim të nenit 6/1 të Konventës.

Në çështjen që përmenda pak më parë “Oleksandr Volkov kundër Ukrainës”, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është shprehur se: “Shprehja “gjykatë e krijuar me ligj” lidhet jo vetëm me bazën ligjore për ekzistencën e vetë gjykatës, por edhe me përbërjen e trupit gjykues në çdo çështje”, dhe në këtë paragraf, gjykata i referohet edhe jurisprudencës së saj të mëparshme, çështjeve “Buskarini kundër San Marino” (çështja me nr. 31657/96) dhe çështjes “Posokov kundër Rosisë” (me nr. 63486/00), dhe vijon më tej argumentim gjykata: “Praktika e zgjatjes në heshtje të mandatit të gjyqtarit për një periudhë kohore të pacaktuar, pas mbarimit të mandatit, është konsideruar shkelje e parimit “gjykatë e krijuar me ligj””, dhe i referon gjithashtu edhe në një çështje tjetër të sajën, çështjen “Gurov kundër Moldavisë” (me nr. 36455/2) në paragrafin 151.

Prandaj, referuar argumentimit që paraqita, në kushtet kur tashmë është formuar një trup gjykues prej tre gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë, vlerësoj që gjyqtari {...} e ka përmbushur detyrimin e tij kushtetues për të qëndruar në detyrë, për të garantuar vazhdimësinë institucionale dhe funksionale të Gjykatës së Lartë, prandaj në zbatim të nenit 61, paragrafi 4 dhe 62 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësimi im personal është që, Këshilli i Lartë Gjyqësor, duhet t’i ofrojë mundësinë që të caktohet në një pozicion në nivel apeli. Ju faleminderit!

**Alban Toro:** A mund të flas Kryetare, t’i kthej edhe përgjigje Erjonit?

**Naureda Llagami:** Në fakt e ka kërkuar fjalën Bruna, Alban.

**Alban Toro:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Shumë shkurt, se tani nuk do bëjmë leksione të së drejtës.

Erjon, ideja është e tillë që puna e detyruar është kur ti e bën kundër vullnetit. Këtë kuptim ka fjala detyrim. Dhe nëse do ta perceptonim kështu, i bie që ne duhet të

merrnim masa ndaj gjyqtarëve që nuk e realizuan këtë detyrim. Se, mospërmbushja e detyrimit është me pasoja. Në këtë kuptim ishte ajo që citova. Thjesht ky është një koment. S'ka nevojë për debat. Thjesht për sqarim.

*Naureda Llagami:* Faleminderit, Bruna!

Alban, shkurtimisht!

*Alban Toro:* Atëherë, në lidhje me “Sindromën e Stokholmit” të cilën e perifranoi shumë qartë Erjoni, në kuptimin figurativ, siç e thashë edhe në krye të herës, të opinionit që unë transmetova, pra është thjesht një opinion, pra një analizë e fakteve dhe nga ajo unë deduktova një opinion. Pra duke marrë parasysh incerinë e KLGJ-së për të zëvendësuar gjyqtarët, të paktën duke filluar nga 12 shkurti, duke parë një dëshirë shumë-shumë të zjarrtë të zotit {...} për të qëndruar në detyrë, të cilën nuk e kuptoj, si dhe duke analizuar edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të cilët në jurisprudencën e saj të shumtë ka theksuar që: “Me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre”.

Më lejo të sjell një shembull të një personi, të një gjyqtari me integritet, të Gjykatës Kushtetuese, i cili në dorëheqjen e tij ka thënë: “Anëtari i Gjykatës Kushtetuese mund të qëndrojë në detyrë deri në zëvendësimin e tij, por mandati nuk mund të zgjatet kaq shumë dhe në mënyrë kaq substanciale. Kjo bie ndesh me Kushtetutën, që parashikon mandatin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese 9-vjeçar”. Sot kemi 16 vjet mandat të zotit {...} në Gjykatën e Lartë, pra nuk bëhet fjalë për substanciale, tej çdo afati të arsyeshëm. Opinioni im është që heshtja, inkurajimi i këtij qëndrimi të çon në “Sindromën e Stokholmit”. Pra është opinion dhe opinionet as nuk ballafaqohen, është thjesht induksion që bën Alban Toro për faktet që ka pas para tavolinës. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toro!

Ndonjë diskutim tjetër nga kolegët, përpara se të shkojmë në çështjet që do hedhim për votim?

Po, zoti Toska!

*Ilir Toska:* Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në lidhje me trajtimin e çështjes së qëndrimit në detyrë të zotit {...}, ka konsideruar si çështje objekt diskutimi nga Këshilli si më poshtë:

1. A i ka mbaruar zotit {...} detyrimi për të qëndruar në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë deri në emërimin e pasardhësit?

2. Në hipotezën që ky detyrim i ka mbaruar, në situatën që zoti {...} vijon të qëndrojë në detyrë, a është Këshilli autoriteti që ka kompetencën për zgjidhjen e këtij ngërçi?

3. Nëse po, cila është mënyra e veprimit të Këshillit?

4. A mund të jetë një vendimmarrje një mënyrë veprimi nga Këshilli?

5. Nëse po, cila vendimmarrje e Këshillit i përgjigjet situatës konkrete?

6. Nëse jo, cila mund të jetë forma e veprimit nga Këshilli?

Lidhur me këto çështje objekt diskutimi, po parashtrij si vijon:

Çështja e parë që duhet të diskutohet sipas mendimit tim është ajo e kompetencës së Këshillit të Lartë Gjyqësor për shqyrtimin e një situate që krijohet nga emërimi i një gjyqtari të ri në Gjykatën e Lartë, në raport me gjyqtarin që i ka mbaruar mandati, por qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, sipas pikës 5 të nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në vlerësimin tim, kompetenca e një organi për shqyrtimin e një çështjeje konkrete rrjedh nga mundësia që ai ka sipas ligjit për zgjidhjen e saj. Duke ardhur në rastin konkret, në Kushtetutë por edhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk ka ndonjë dispozitë që rregullon situatën objekt diskutimi, në kuptimin e përcaktimit të rregullave të caktuara dhe të organit publik që ka përgjegjësinë për mbikëqyrjen e respektimit të këtyre rregullave dhe zgjidhjen kur është rasti të situatave që mund të krijohen. Por nga ana tjetër, nisur nga përgjegjësia kushtetuese e Këshillit të Lartë Gjyqësor për sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë (neni 147, pika 1 e Kushtetutës) si dhe funksionet kushtetuese të tij, sipas nenit 147/a të Kushtetutës, të zbërthyer më tej në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e

gjqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mendoj se Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke qenë organi përgjegjës për statusin dhe në veçanti për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve të të gjithë niveleve, me përjashtim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, ka kompetencën për shqyrtimin dhe zgjidhjen e çdo situatë që mund të lind në lidhje me karrierën e çdo gjyqtari, përfshirë edhe atë të Gjykatës së Lartë.

Lidhur me këtë moment, vlen të theksohet se legjislacioni në fuqi nuk ka ngarkuar ndonjë organ tjetër në trajtimin dhe zgjidhjen e ndonjë situatë të tillë.

Sa i përket çështjes nëse zoti {...} i ka mbaruar detyrimi kushtetues për të qëndruar në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, mendoj se duhen mbajtur në konsideratë ngjarjet që kanë ndodhur deri më sot, të përshkruara hollësisht në relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, por edhe parimet e vazhdimësisë, funksionalitetit, sikundër edhe ato të pavarësisë dhe të paanësisë së gjykatës, të cilat referuar dokumentave ndërkombëtarë bazë për gjyqësorin, janë me rëndësi primare për ekzistencën dhe funksionimin e saj, në veçanti për legjitimitetin e gjykatës.

Rezulton se mandati kushtetues 9-vjeçar i z. {...} si anëtar i Gjykatës së Lartë ka mbaruar pas kalimit të 9 viteve, pikërisht në datë 17 shkurt 2014. Në përputhje me ligjin e kohës, nenin 4 të ligjit 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kryetari i Gjykatës së Lartë, një muaj përpara mbarimit të mandatit të z. {...}, ka njoftuar Presidentin e Republikës mbi përfundimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, z. {...}. Për vakancën e krijuar në këtë rast, Presidenti i Republikës ka filluar procedurën e emërimit të pasardhësit të zotit {...}. Kjo procedurë nuk është finalizuar, pasi Kuvendi i Shqipërisë nuk dha pëlqimin për dekretin e emërimit të nxjerrë nga Presidenti i Republikës. Pas kësaj nuk ka pasur procedurë emërimi tjetër derisa, pas krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ky Këshill, më datë 9 korrik 2019, filloi procedurën e emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, për tre pozicione të lira, përfshirë edhe për pozicionin që mbante zoti {...}, tashmë sipas përcaktimit të bërë në pikën 5 të nenit 136 të Kushtetutës. Ndërkohë, më datë 25 korrik 2019 (vetëm 2 javë mbas), në Gjykatën e Lartë u krijua edhe një pozicion tjetër i lirë për shkak të shkarkimit të një gjyqtari të kësaj gjykate, gjyqtar edhe ky i ardhur nga radhët e jogjyqtarëve. Për shkak të krijimit të një pozicioni tjetër të lirë, Këshilli më datë 11

shtator, filloi një procedurë tjetër emërimi në Gjykatën e Lartë, nga radhët e jogjyqtarëve, duke plotësuar kështu numrin maksimal të këtyre procedurave që mund të hapte për jogjyqtarët.

Tre procedurat e para të emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, u finalizuan më datë 11 mars 2020, ndërsa Presidenti i Republikës dekretoi emërimin e tre anëtarëve të Gjykatës së Lartë, të propozuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, të cilët pas betimit më datë 13 mars 2020, filluan ushtrimin e detyrës.

Nga ana tjetër, z. {...} vijon të qëndrojë në detyrë, sipas shpjegimeve të tij, me arsyetimin se ka detyrimin kushtetues të qëndrojë deri në emërimin e pasardhësit, i cili sipas tij është ai që do të emërohet në përfundim të procedurës së katërt të emërimit.

Sikurse Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vlerësuar në korrespondencën me Presidentin e Republikës përpara emërimit të tre anëtarëve të Gjykatës së Lartë, nga radhët e jogjyqtarëve, se asnjë prej tyre nuk zëvendëson nominalisht zotin {...}, mendoj se emërimi dhe fillimi i ushtrimit të detyrës nga tre anëtarët e rinj të Gjykatës së Lartë, pra jo të njërit, apo të parit prej tyre, në situatën hipotetike të mospasjes edhe të një pozicioni tjetër të lirë të mëvonshëm në këtë gjykatë, do t'i çonte në përfundimin e detyrimit të zotit {...} për qëndrimin në detyrë.

Thënë këtë, vlerësoj se në respektim të parimit të vazhdimësisë dhe funksionalitetit, në kushtet kur vetëm z. {...} vijonte të qëndronte në detyrë, anëtari i tretë i ri i Gjykatës së Lartë do duhet të konsiderohej si pasardhës i z. {...}.

Por, si edhe më lart përmenda, në Gjykatën e Lartë është krijuar ndërkohë edhe një pozicion tjetër i lirë që mund të plotësohet nga radhët e jogjyqtarëve, pozicion për të cilin Këshilli i Lartë Gjyqësor është duke zhvilluar procedurën e emërimit, e cila nuk është finalizuar ende. Në këtë pozicion nuk ka gjyqtar në detyrë. Nisur nga kjo, në respektim të parimit të vazhdimësisë dhe funksionalitetit të Gjykatës së Lartë është i mundur interpretimi sipas të cilit, detyrimi i z. {...} për qëndrimin në detyrë, përfundon vetëm me emërimin dhe fillimin e ushtrimit të detyrës së anëtarit të katërt të ri. Por në rrethanat e rastit konkret, ndërsa aktualisht Gjykata e Lartë ka në detyrë 3 anëtarë të rinj të sapo emëruar, pra ka funksionalitetin minimal të saj, në kushtet kur zoti {...} është në detyrë pas përfundimit të mandatit tashmë në vitin e 7, ndërkohë që vijimi i qëndrimit të tij në detyrë nuk garanton funksionimin normal të Gjykatës së Lartë, mendoj se duhet të

marrin përparësi parimet e pavarësisë dhe paanësisë së gjykatës në kuptimin e legjitimitetit të saj. Thënë këtë, kam parasysh vendimin nr. 41 të vitit 2012 të Gjykatës Kushtetuese e cila në këtë rast ka bërë interpretimin e një dispozite kushtetuese për gjyqtarin kushtetues, pikërisht për detyrimin e qëndrimit të tij në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, të njëjtë me përcaktimin e bërë sipas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se (pika 19 e vendimit):

“19. Legjitimiteti kësaj gjykate është çështje e padiskutueshme, pasi ajo funksionon tërësisht brenda kritereve dhe kushteve të përcaktuara nga Kushtetuta. Funkcioni themelor i gjykatës është garantimi i respektimit të Kushtetutës, interpretimi përfundimtar dhe sigurimi i epërsisë së saj në sistemin ligjor, nëpërmjet dhënies së drejtësisë kushtetuese. Në këtë këndvështrim, gjykata rithekson edhe një herë se rregulli i vazhdimësisë së qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues është parashikuar për të garantuar, mbi të gjitha, funksionimin normal të gjykatës në rast të krijimit të vendeve vakante, si pasojë e mosveprimit të ndonjërit prej organeve, të cilave Kushtetuta u njeh një rol të veçantë në këtë moment për zëvendësimin e gjyqtarëve të vjetër me gjyqtarë të rinj. Nisur edhe nga natyra kolegjiale e këtij organi të pavarur kushtetues, çdo mosveprim do të kishte pasoja në funksionimin e Gjykatës. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se, ndërsa vazhdimi i qëndrimit në detyrë të gjyqtarëve kushtetues, sipas nenit 125/5 të Kushtetutës, përbën një detyrim për ta, kjo nuk do të thotë se Presidenti dhe Kuvendi mund të zgjasin tej çdo afati të arsyeshëm procedurat e zëvendësimit të tyre. Ata, bashkërisht, pa mbaruar ende mandati 9-vjeçar i gjyqtarëve, duhet të marrin masat e nevojshme si për përcaktimin e modaliteteve juridike procedurale, ashtu edhe për zëvendësimin e tyre brenda afateve procedurale të arsyeshme, me synim që të respektohet edhe detyrimi që buron nga neni 125/2 i Kushtetutës”.

Po ashtu, për këtë moment, kam parasysh edhe qëndrimet e gjyqtarëve në pakicë në këtë vendim, të cilët kanë arsyetuar në mënyrë më të zgjeruar. Konkretisht po citoj një pjesë të mendimit të pakicës së njërit prej gjyqtarëve:

“Problemi kryesor që meriton vëmendje të veçantë është ruajtja e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës. Vazhdimësia e drejtësisë kushtetuese dhe përtëritja, si proces kushtetues, janë në funksion të ruajtjes dhe forcimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së



gjykatës. Vetë Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Ndërhyrja në funksionimin e gjykatave, si instrument i balancës, duhet të rregullohet në mënyrë të tillë që pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave të mos shkelet.

Sipas nenit 125/2 të Kushtetutës, gjyqtarët kushtetues emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi. Kjo dispozitë, duke sanksionuar në mënyrë të qartë një kohëzgjatje të caktuar të mandatit kushtetues, përbën një nga faktorët që garantojnë pavarësinë e gjykatës. Një mandat kushtetues i parashikuar specifikisht në kohëzgjatje, shmang rrezikun e influencës dhe presioneve politike ndaj gjyqtarit, duke qenë se këtij të fundit i garantohet kohëzgjatja dhe paprekshmëria e mandatit. Gjykata, në vendimin nr. 24/2011, ka nënvizuar se: Vetëm një gjykatë “e pavarur”, së cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese. Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë. Mbarimi ose ndërprerja e mandatit të një gjyqtari kushtetues, në bazë të vendimit të organit që e ka zgjedhur atë dhe jo sipas një procedure ligjore të përcaktuar, me të cilën gjyqtari është njohur dhe e ka pranuar në momentin e zgjedhjes së tij, është e papajtueshme me parimet kushtetuese.

Rregulli i vazhdimësisë së qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues deri në emërimin e pasardhësit të tij, i parashikuar në nenin 125/5 të Kushtetutës, garanton mbi të gjitha funksionimin normal të gjykatës. Megjithatë, kjo dispozitë, ashtu si çdo dispozitë e Kushtetutës, duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, në lidhje me dispozitat e tjera dhe brenda kontekstit të saj. Rrjedhimisht, në përputhje me frymën e Kushtetutës, qëndrimi në detyrë i gjyqtarit kushtetues deri në emërimin e pasardhësit të tij nënkupton respektimin e tri parakushteve: së pari, Presidenti dhe Kuvendi duhet të ushtrojnë vullnetin e tyre nëpërmjet akteve përkatëse, brenda kompetencave që u janë dhënë nga Kushtetuta; së dyti, këto organe

duhet të veprojnë brenda një kohe të arsyeshme dhe sipas një procedure transparente ku janë të përcaktuara në mënyrë të qartë afatet kohore të domosdoshme për mbylljen normale të procedurës së emërimit të gjyqtarit të ri; dhe së treti, vazhdimësia e gjyqtarit në detyrë duhet të kuptohet dhe zbatohet si një vazhdimësi brenda një kohëzgjatjeje të arsyeshme. Një periudhë e gjatë qëndrimi në detyrë pas mbarimit të mandatit, e cila mund të përbëjë konsumim të një pjese substanciale të mandatit të rregullt 9-vjeçar, megjithëse nuk është funksionalisht ekuivalente me një riemërim, juridikisht rrezikon t'i ngjajë një riemërimi, në shkëlqje të nenit 125/2 të Kushtetutës. Shumica shprehet në mënyrë të përgjithshme se, si në rastet e përfundimit para kohe të mandatit të gjyqtarit, ashtu edhe në rastet e përfundimit normal të mandatit, zëvendësimi i tij duhet të bëhet brenda një afati të arsyeshëm, por pa bërë një vlerësim nëse afati i arsyeshëm është respektuar apo jo në rastin konkret.”

Nga sa parashtrova, duke qenë se për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë tashmë ka të njëjtat rregullime sikundër ajo ka pasur për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me mandatin, kohëzgjatjen e tij dhe ndalimin e riemërimit të tij, duke vlerësuar se qëndrimi në detyrë të zotit {...} deri në këtë moment ka qenë i përligjur, vijimi i qëndrimit të tij tashmë nuk justifikohet me parimin e vazhdimësisë dhe funksionalitetit të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër, për një funksionalitet më të mirë të Gjykatës së Lartë, duke respektuar masat kundër përhapjes së COVID-19, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet sa më parë të përfundojë procedurën e emërimit për pozicionin e katërt të lirë nga radhët e jogjyqtarëve, sikundër të shpejtojë procedurat e hapura për pozicione të lira të cilat duhet të plotësohen nga radhët e gjyqtarëve.

Sa i përket mënyrës së veprimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, mendoj se ajo duhet të jetë përmes një njoftimi drejtuar zotit {...}, sikundër edhe Gjykatës së Lartë, përmes të cilit të bëhet me dije përfundimi i detyrimit të tij për qëndrimin në detyrë, sikurse ai të ftohet për të ushtruar të drejtën për t'u caktuar në nivel apeli sipas përcaktimit të pikës 4 të nenit 61 dhe nenit 62 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zoti Toska!

Para se të ngremë çështjet për diskutim, unë do doja nëse ka ndonjë koleg tjetër

për të ezauruar ndonjë mendim.

**Fatmira Luli:** Shkurtimisht do doja t'i bëja edhe unë një pyetje Brikenës.

**Naureda Llagami:** Po, Fatmira!

**Fatmira Luli:** Brikena, desha të drejtohem me pyetjen, në rastin kur ne kemi shpallur tre vendet vakante në Gjykatën e Lartë, për vendet bosh që shpallëm konkurrimin, për anëtarët juristë jogjyqtarë, vendi i zotit {...} përfshihesh në këto tre vendet e shpallura? – Kjo ishte pyetja e parë.

Dhe pyetja e dytë, - Pasardhësit që u emëruan në këto tre vende, konsiderohen sipas nenit 136/5 pasardhës pikërisht të vendeve të shpallura nga ne në këtë procedurë konkurrimi? Sepse ne kemi votuar në lidhje me të dyja këto vendimmarrje dhe kemi votuar si Këshill me unanimitet të plotë. Këto çështje kisha, po munde të përgjigjesh.

**Brikena Ukperaj:** Nuk e kuptoj pse ma ngre si pyetje, kur jep konstatimet e tua lidhur me të dyja këto pyetje?

**Fatmira Luli:** Dua ta bëj pyetjen sepse u nise, kur shpjegove tek relacioni që bëre, shpjegove që ne nuk kemi votuar për pasardhësin, nuk kemi votuar për zotin {...} nominalisht, për shpalljen e vendit të tij, dhe prandaj desha të të pyes, nëse ato tre vende që ne kemi shpallur, përfshihesh vendi i zotit {...} apo jo?

**Brikena Ukperaj:** Mandati i zotit {...} është një mandat i përfunduar dhe unë këtë nuk e vura në diskutim dhe ky mandat është i përfunduar dhe u mor në konsideratë jo vetëm për shpalljen e pozicioneve, por edhe për shpalljen e pozicionit të zotit {...}. Nuk mundet t'i analizojmë të dyja vendimet të shkëputura nga njëra-tjetra. Ne nuk kemi marrë ndonjëherë vendim për të cilësuar se kush është pasardhësi i zotit {...}. Sot po e diskutojmë këtë gjë, ku secili po shpreh mendimin e vet se cili nga të tre, i pari, i katri, do të konsiderohet pasardhësi i zotit {...}.

**Fatmira Luli:** Okej!

Atëherë, shkurtimisht desha të jap edhe unë opinionin tim lidhur me këtë diskutim. Unë gjykoj që ne kemi diskutuar dhe votuar në këtë Këshill për vendet e shpallura vakante në Gjykatën e Lartë, mes të cilave ka qenë edhe vendi i zotit {...}. Ne kemi shpallur tre vende vakante për shkak të ndryshimeve ligjore që pati Kushtetuta, të

strukturës që duhet të kishte Gjykata e Lartë, me 1/5 e anëtarëve jogjyqtarë dhe për këtë shkak, nga 6 ish-gjyqtarë, tashmë ishin 3 dhe të tre vendet bosh nuk ishte vendi i zotit {...}, por ishin vendet e gjyqtarëve të cilët vinin nga jashtë gjyqësorit, mes të cilëve ishte edhe vendi i lirë i zotit {...}. Në këto kushte, edhe kandidaturat për të cilat ne votuam dhe i propozuam Presidentit, ishte pikërisht njëri nga ato e z. {...}, pa përcaktuar nëse ishte i pari apo i treti. Pra ne kemi votuar si Këshill për zëvendësimin edhe për vendin vakant të z. {...} edhe për gjyqtarin që e zëvendëson z. {...}.

Kështu që mendoj që ne nuk kemi ndonjë kompetencë nga ligji të diskutojmë sot për mandatin ose për zëvendësimin e tij sepse këtë e kemi shprehur unanimitet në votimet e mëparshme. Jam e idesë me propozimin që ka bërë Komisioni që kjo do jetë çështje njoftimi dhe Komisioni i Karrierës duhet të procedojë siç ka proceduar në tërë rastet e tjera për anëtarët e Gjykatës së Lartë që u kishte mbaruar mandati dhe e kishin dorëzuar detyrën. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, ka më diskutime?

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, unë do doja që ne si Këshill të hedhim në votim çështjen për të cilën ne e bëmë edhe objekt diskutimi në mbledhjen plenare, e cila ka të bëjë me vijimin e qëndrimit në detyrë të zotit {...}, si gjyqtar i Gjykatës së Lartë... nëse duhet zoti {...} të qëndrojë në detyrë si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, deri në emërimin e pasardhësit të tij, që në rastin konkret, në situatën faktike, është pozicioni i katërt që Këshilli ka hapur.

**Brunilda Kadi:** Kush e bëri këtë propozim, Kryetare?

**Naureda Llagami:** Sepse është një nga pyetjet e para që është sjellë këtu Bruna.

**Brunilda Kadi:** Jo, jo! Kemi propozimin e relatores fillimisht.

**Naureda Llagami:** Mirë pra. Propozimi i relatores është “A i ka mbaruar zotit {...} detyrimi për të qëndruar në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë deri në emërimin e pasardhësit?”

**Marçela Shehu:** Duhet të vendosim se si duhet të procedojmë me mënyrën e të votuarit sepse janë 6 pyetje të cilat janë paraqitur nga Komisioni, për të cilat ne duhet të vendosim a duhet të votojmë një e nga një dhe, relatori ka një propozim më vete, që me

aq sa unë kuptova është i njëjtë edhe me mendimin e zotit Toska.

**Ilir Toska:** Atëherë, mund të ndërhyj?

Faleminderit! Atëherë, tre janë çështjet që ne mund të votojmë:

Çështja e parë është çështja e kompetencës së Këshillit për ta shqyrtuar këtë rast; çështja e dytë është propozimi që bëri zonja Marçela dhe disa nga anëtarët e mbështetën që zotit {...} i ka përfunduar detyrimi për qëndrimin në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe e fundit; është mënyra se si duhet të veprojë Këshilli, -që disa nga anëtarët propozuan që të bëjmë një njoftim zotit {...} dhe Gjykatës së Lartë për t'i bërë të ditur që ka përfunduar detyrimi për qëndrimin në detyrë dhe për ta ftuar atë për të ushtruar të drejtën për t'u caktuar në nivel apeli, sipas ligjit "Për statusin...". Pra për tre çështjet i bie që të votojmë.

**Naureda Llagami:** Atëherë, për çështjen e parë, nëse kemi kompetencë apo jo, unë mendoj që nga ana e Këshillit tashmë u bënë diskutimet lidhur me themelin e çështjes, kështu që edhe mënyrën se si kemi vepruar, unë nuk gjykoj se kemi më lëndë për të diskutuar këtë gjë. Nëse ju e vlerësoni, ne mund ta kalojmë në votim, thjesht për procedurë.

**Ilir Toska:** Jo, jo! Nuk e bëjmë thjesht për procedurë. Në fakt, kanë folur vetëm disa nga anëtarët. Të gjithë kanë konsideruar që është një çështje e Këshillit. Ka anëtarë që nuk kanë diskutuar. Mundet që ndonjë prej tyre të ketë opinionin që kjo nuk është çështje e Këshillit. Unë nuk e di nëse ka ndonjë këtë opinion. Prandaj ngrita si çështje, për t'u diskutuar, qëllimisht, çështjen e kompetencës.

**Brunilda Kadi:** Mund të them diçka Kryetare, të lutem!

**Naureda Llagami:** Po, Bruna!

**Brunilda Kadi:** Atëherë, unë mendoj që kjo çështje është ezauruar sepse kur Këshilli vendosi me shumicë votash që këtë proces ta quante proces administrativ dhe për këtë duhet të njoftohesh zoti {...}, më duket se ky moment është kapërcyer disa herë. Jo vetëm që kemi kompetencë por ne kemi hyrë në një proces administrativ konkret. Çfarë do votohet këtu? –Që a bëmë mirë atëherë kur e bëmë këtë gjë? Çfarë do votojmë?

**Ilir Toska:** A mund të flas zonja Kadi?

**Brunilda Kadi:** Po, mundet të flasësh zoti Toska!

**Ilir Toska:** Nëse ne paskemi vendosur, nuk e di që paskemi vendosur?!

Ne kemi ndjekur një procedurë që ndjek Këshilli në çdo rast tjetër. Në çështjet që

kemi vënë si Komision që duhet të diskutojë dhe vendosë Këshilli, është edhe kjo çështje. Nuk e di çfarë i kushton gjithsecilit të shprehet për këtë çështje, qoftë edhe me votë, sa kohë nuk ka ndonjë diskutim. Kaq e thjeshtë është.

**Brunilda Kadi:** Thjesht që, unë mendoj që e pengon absurditeti. Se në momentin që e konsideron proces administrativ, ti jo vetëm që je kompetent, por ke hyrë në një proces tashmë dhe po ndjek hapat e tij. Si mund të hysh në një proces administrativ pa qenë kompetent? Unë mendoj që kjo është pengesa e votimit, absurditeti.

**Ilir Toska:** Faleminderit shumë për absurditetin që ma bën me dije znj. Kadi, por ju që në krye të herës nuk keni dashur të ketë ndonjë proces, kështu që...

**Brunilda Kadi:** Dhe kam votuar kundër zoti Toska për këtë gjë, edhe për votimin tuaj që është proces administrativ, dhe që të njoftoni zotin {...}. Edhe sot e përsërita disa herë që nuk është një proces administrativ, është thjesht një veprim administrativ që e njofton zotin {...} që nuk vijon më detyrën, meqenëse ai vazhdon ta vijojë.

**Ilir Toska:** Zonja Kadi, duhet të keni mirësinë t’i dëgjoni anëtarët deri në fund. Ju nuk mund të ndërhyri sa herë të doni ju dhe t’ia ndërprisni fjalën të tjerëve. Kini durimin...

**Brunilda Kadi:** Nuk jua ndërpreva fjalën zoti Toska.

**Ilir Toska:** Unë isha duke folur zonja Kadi.

Ja edhe tani, unë duke folur, ti prapë ndërhyri.

Mund të kesh pak edukatën që të më thuash – “Mbarove?” Dhe të flasësh sa të duash ti.

**Brunilda Kadi:** Mendoj që edukatën e tregoj gjithmonë unë zoti Toska.

**Ilir Toska:** Ndërhyri vend e pa vend.

**Brunilda Kadi:** Po nuk e vlerësoni juve vendin dhe pavendin kur ndërhyri unë.

**Ilir Toska:** Unë kur flet ti, nuk ndërhyri.

**Brunilda Kadi:** As unë. Mendova që mbaruat, se ishte pauzë mbas fjalës tuaj, zoti Toska. Unë e dhashë mendimin tim që s’ka kuptim të hidhet në votim kompetenca. Se të njëjtën gjë më duket tha edhe Kryetarja.

**Naureda Llagami:** Po! Të njëjtën ide kisha edhe unë Bruna. Por ndoshta kolegët kanë ide të ndryshme dhe le të respektojmë situatën se si e mendon secili nga kolegët.

**Brunilda Kadi:** Kryetare, unë nuk e vendosa që nuk e hedhim në votim. Thashë

mendimin tim. Hedhja në votim është absurditet. Kaq thashë unë. Thashë mendimin tim. Unë nuk kam asnjë fuqi vendimmarrëse. Kam vetëm votën time dhe kuptohet, mendimin tim.

**Naureda Llagami:** Atëherë, meqë kemi dy propozime: Propozimi i parë nëse Këshilli ka kompetencë për ta shqyrtuar çështjen dhe më pas propozimi i dytë, propozimi i relatores, në bazë të së cilit zotit {...} i ka mbaruar detyrimi për të qëndruar në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe duhet të njoftohet nga ana e Këshillit për të përzgjedhur një vend në gjykatat e apelit.

Kalojmë në votim lidhur me kompetencën e Këshillit për shqyrtimin e kësaj çështjeje, a është Këshilli i Lartë Gjyqësor kompetent për shqyrtimin e çështjes.

Edhe një herë, kam hapur procesin e votimit.

Çështja e parë: A është Këshilli kompetent?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Patjetër që jam dakord, se ne jemi tashmë, e kemi marrë kompetencën dhe po e shqyrtojmë.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord. Mendoj që Këshilli është i vetmi organ kompetent për ta trajtuar dhe për ta zgjidhur situatën në këtë rast.

**Erjon Muharremaj:** Pro. Me arsyetimin që paragrafi i parë i nenit 147 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ngarkon Këshillin e Lartë Gjyqësor për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë dhe Gjykata e Lartë është pjesë e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor është kompetent për të trajtuar këtë çështje. Faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Dakord, sepse këtë gjë kemi bërë deri tani, dhe një vendim i kundërt do të zhvlerësonte të gjithë procedurën që kemi ndjekur.

**Medi Bici:** Dakord edhe unë, me arsyetimin që bëri Erjoni dhe Brikena.

**Naureda Llagami:** Dakord edhe nga ana ime.

Atëherë, Këshilli ka kompetencë për ta shqyrtuar.

Le të kalojmë tani në propozimin e bërë nga relatori i çështjes, i cili ashtu sikurse e shpreha, propozon që detyrimi i zotit {...} ka mbaruar, për të qëndruar në detyrë, si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, dhe që nga ana e Këshillit duhet të njoftohet në respektim të detyrimeve, për t'i dhënë të drejtën për të zgjedhur në gjykatën e apelit, një pozicion në gjykatën e apelit.

Kalojmë në votim.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Më fal Kryetare që ndërhyj, mbase duhet ndarë (le të flasë vetë Marçela), se mendoj që janë dy gjëra të ndryshme për t'u hedhur në votim.

**Naureda Llagami:** Bruna, e thashë një herë, dhe kemi hyrë në procedurë votimi, të lutem mos ndërhy në procedurë votimi.

Unë e përsërita. Duhet ta kishe bërë një sugjerim.

**Brunilda Kadi:** Është çështje teknologjie. Kërkova por s'ndërhyra.

**Naureda Llagami:** Ke të drejtë.

Le ta kalojmë dhe le ta saktësojmë më pas.

**Brunilda Kadi:** E kam të vështirë këtë votim zonja Kryetare sepse kam mendim të ndryshëm për pjesën e parë nga pjesa e dytë. Kështu që duhet ndarë.

**Marçela Shehu:** Kryetare, atëherë, propozimi që ju cituat ishte të shprehemi nëse i ka mbaruar apo jo detyrimi kushtetues zotit {...} për të qëndruar në detyrë dhe bërja me dije për të zgjedhur një nga vendet në Gjykatën e Apelit.

Nga diskutimet dhe debatet që patëm sot në Këshill, një nga anëtarët apo disa (se nuk isha shumë e vëmendshme) janë të mendimit që zotit {...} duhet t'i ofrohet e drejta për të zgjedhur një pozicion në nivel apeli, nëse ai plotëson kriteret për këtë pozicion. Prandaj, unë propozoj që propozimi të ndahet në dy pjesë.

**Naureda Llagami:** Të jetë një propozim i tretë.

Pra ky është një propozim që është i relatorit dhe më pas formulojmë propozimin e anëtarëve të tjerë, për këtë që thatë ju.

Unë e nisa me propozimin e relatorit. Nëse propozimi i relatorit ishte kështu, ky



do të kalojë i pari. Më pas kalojmë tek propozimet e anëtarëve. Dakord?

**Marçela Shehu:** Do kalohet propozimi siç është bërë nga relatori. Kjo do votohet. Pastaj, nëse ka...

**Naureda Llagami:** Kemi filluar procedurën e votimit. Ju lutem, nuk ka më. Mbarojmë këtë votim dhe pastaj kalojmë në një propozim tjetër. Të lutem Bruna, voto për këtë.

Vijon votimi, aty ku e la zoti Qoku.

**Brunilda Kadi:** Atëherë, unë jam dakord me pjesën e parë që zotit {...} i ka mbaruar e drejta dhe detyrimi (siç e quajnë një pjesë e anëtarëve) për të vazhduar ushtrimin e funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Lartë, pra jam pro kësaj, dhe kundër propozimit që ai ka drejtë të zgjedhë për t'u caktuar në një gjykatë në nivel apeli, pasi nisur nga përvoja profesionale që ka zoti {...}, mendoj që nuk i plotëson kriteret për asnjë nga apelet të çdo juridiksioni në Republikën e Shqipërisë.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro. Me arsyetimin që bëra gjatë fazës së diskutimit përpara votimit.

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, unë jam kundër sepse edhe sikundër arsyetova, vlerësoj që ky detyrim për zotin {...} mbaron në momentin kur emërohet anëtari i katërt që vjen nga juristët e spikatur.

**Medi Bici:** Kundër. Me arsyetimin që gjyqtari {...} duhet të rrijë në detyrë derisa të vijë juristi i katërt i spikatur.

**Naureda Llagami:** Kundër. Me të njëjtin argument si zoti Bici.

Atëherë, shumica vlerësoi që zotit {...} i ka mbaruar detyrimi për të qëndruar në detyrë dhe do t'i njoftohet e drejta e tij për t'u caktuar në një nga pozicionet në nivel gjykate apeli.

**Brunilda Kadi:** Jo! Një sekondë Kryetare.

Duhet të numëroni votat sepse kundër pjesës së dytë, ndahen votat 5 me 5.

Pra jam unë kundër pjesës së dytë, janë edhe katër anëtarë që votuan kundër totalisht, kështu që. Prandaj duhesh të ndaheshe votimi.

**Naureda Llagami:** Bruna, më duket se nuk po e lexon saktë votën.

Shumica vlerësoi dhe vendosi që zotit {...}, për pikën e parë, i ka mbaruar.

Vetëm ti ke ndryshim tek pika e dytë, tek njoftimi.

**Brunilda Kadi:** Që jam kundër.

**Naureda Llagami:** Asnjë nga anëtarët e tjerë nuk e bëri këtë rezervën që kishit ju, që të shprehte edhe ai rezervë për kundër. Automatikisht, të gjithë e vlerësuan në tërësi propozimin e relatores.

**Brunilda Kadi:** Jo, jo!

Okej Kryetare! Unë vlerësoj që, ata që votuan kundër, votuan kundër për të dyja pikat. Sepse kur ti voton dhe thua që i vazhdon detyra, nuk mund të votosh që ka të drejtë të shkojë në apel. Se s'bën sens kjo. Prandaj unë thashë që duhet të ndani votimin. Mbase mund ta hidhni për herë të dytë votimin. Meqenëse Këshilli, me shumicë, votoi që zoti {...} nuk vijon më detyrën në Gjykatën e Lartë, atëherë të hidhet në votim tashmë, mbi bazën e kësaj mazhorance të këtij vendimi të Këshillit, nëse ai ka të drejtë të caktohet në apel, dhe secili të votojë tani.

Unë paraprakisht e kam shprehur, por për procedurë duhet të votojnë të gjithë. Është pa vendimmarrje kjo pjesë. Ose po ta lexoni votën, i bie që është kundër. Ngaqë ju keni dy vota. U ndanë 5 me 5.

**Naureda Llagami:** Atëherë, edhe një herë, hedhim në votim vetëm për paragrafin e dytë, për njoftimin.

**Brunilda Kadi:** Po! Bën sens.

**Naureda Llagami:** Jeni dakord me propozimin që ka bërë Bruna.

**Maksim Qoku:** Cili është propozimi i Brunës ta marrim vesh të lutem?

**Brunilda Kadi:** Jo! Nuk është propozimi i Brunës. Unë po propozoj procedurën. Maksi, meqenëse u votua 6 me 4, pra që nuk vijon funksionin.

Duke qenë pastaj që në total janë 5 vota kundër që ai të zgjedhë për t'u caktuar në apel, -si zgjidhet ky rast? Prandaj duheshin ndarë votimet. Me këtë votim iu bie pjesa e dytë, pra ato që votuan pro caktimit, iu bie sepse u votua 5 me 5 kundër. Kryetarja në

këtë rast ka 2 vota. Ajo votoi kundër, kështu që fiton kundër pjesa e dytë. Nëse nuk është ky vullneti i Këshillit, ndoshta duhet ta hidhni edhe një herë tjetër në votim.

**Alban Toro:** Më duket se pjesa e dytë u ezaurua përfundimisht. Kështu që nuk kemi çfarë votojmë prapë. Që do të thotë është kundër. Pra vota e Kryetarit shkon me pjesën që nuk e pranojnë. Në këtë kuadër është kundër. Fiton kundër. Ndërsa pjesa e parë mbetet minorancë.

**Naureda Llagami:** Atëherë, nëse ne votuam, personalisht, nëse votuam kundër, ishte kundër pjesës së mbarimit të mandatit dhe automatikisht kundër njoftimit për t'u caktuar në apel. Ky është shpjegimi i votës time.

**Maksim Qoku:** Për t'i çuar njoftimin.

**Naureda Llagami:** Për t'i dërguar pra, se janë gjërat e lidhura. Nëse unë votoj kundër mandatit në tërësi, automatikisht ...

**Maksim Qoku:** ...kundër për t'i çuar njoftimin.

**Naureda Llagami:** Po!

Tani, për efekt të procedurës, le të hedhim pjesën e dytë, le të hedhim propozimin e relatores lidhur me njoftimin e zotit {...} për t'u caktuar në apel dhe më pas hedhim propozimin....

**Alban Toro:** Më fal, Naured se po e keqinterpretton.

Propozimi i relatorit ishte: E para, që atij i ka mbaruar detyrimi ose e drejta për të vijuar detyrën. E dyta, ishte e drejta për caktim në nivel apeli; të cilat në votim, të dy pjesët morën përgjigje. Për pjesën e parë u votua që i ka mbaruar detyrimi dhe e drejta për të vazhduar ushtrimin e funksionit në Gjykatën e Lartë. Pjesa e dytë, e drejta për t'u caktuar në nivel apel, fituan ata që e kanë votën e Kryetares. Kështu që është e ezauruar kjo. Nuk kemi çfarë i votojmë prapë nga fillimi.

**Brikena Ukperaj:** Mund ta shpjegoj votën time, para se ta shpjegosh ti votën time?

**Alban Toro:** Nuk ka nevojë për shpjegime, Brikena, sepse relatorja e tha.

**Brikena Ukperaj:** Të lutem. Vota ime ka qenë kundër qëndrimit. Domethënë vota ime ka qenë pro qëndrimit dhe kundër detyrimit të mbarimit të mandatit. Për rrjedhojë, nuk kam nevojë që t'i dërgojë njoftim. Kjo ka qenë vota ime.

Tani, ajo që thotë Bruna, ka të bëjë me, a ka ai të drejtë të shkojë apo jo në

gjykatën e apelit? – është tjetër gjë kjo.

**Brunilda Kadi:** Po unë e sqarova votën o Brikena për çfarë po votoja. Pse u ngatërruat juve?

**Alban Toro:** Mos e deformoni votimin.

Relatorja e bëri të qartë propozimin dhe e hodhi në tavolinë. Madje edhe kur kërkoi që të ndahej votimi, nuk u pranua dhe u vazhdua me të njëjtin propozim. Propozimi kishte dy komponentë. Komponenti i parë ishte që të qëndronte në detyrë apo jo pra të mos vijonte ushtrimin e funksionit dhe pjesa e dytë, pjesë përbërëse e të parës ishte, si rregullim i pasojës, e drejta për caktim në nivel apeli. Kjo pjesë fatkeqësisht mori votën kundër të Kryetares dhe duke qenë e barabartë, vota e Kryetares shkon me pjesën kundër. Nuk e di çfarë duhet të sqarojmë tjetër?

**Ilir Toska:** Kam përshtypjen që shumica vendosi që zotit {...} i ka mbaruar detyrimi për të qëndruar në Gjykatën e Lartë. Nga ana tjetër, në rrjedhjet e kësaj, relatorja propozoi që duhet t'i bëhet njoftimi. Nëse mendoni që është i paqartë votimi a duhet t'i bëhet njoftimi apo jo zotit {...} për t'u ftuar për t'u caktuar në nivel apeli, e hedhim në votë.

**Maksim Qoku:** Ilir, kjo duhet hedhur në votë sepse nëse ne votuam kundër për faktin që s'i ka mbaruar, duhet të votojmë edhe për faktin që a duhet të njoftohet.

**Brunilda Kadi:** Prandaj duhet të ishin ndarë votimet, se është alogjike.

**Maksim Qoku:** Unë jam me parashtrimin që bëtë ju qëparë, me tre çështjet: kompetenca, përfundimi i detyrimit dhe njoftimi. Pra të treja të votohen. Dy u votuan. Të votojmë të tretën. Të sqarohet vota më mirë. Asgjë s'ka.

**Brunilda Kadi:** Po pse s'e sqarove o Maksi kur u hodh në votim, siç kërkova unë që të sqarohesha.

**Maksim Qoku:** Unë po e them që bëra të parën, bëra të dytën. Nëse është për njoftimin, unë i referohem pikës së dytë.

**Brunilda Kadi:** Prandaj duheshin ndarë si votime ato se janë dy gjëra të komplet të ndryshme.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë edhe një herë tek votimi i njoftimit që u propozua nga relatorja, që do i bëhet zotit {...}.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Kundër, siç e shpjegova sepse nuk plotëson kriteret për t'u caktuar në apel.

**Ilir Toska:** Dakord sepse isha bashkë me shumicën që zotit {...} i ka mbaruar qëndrimi dhe për këtë shkak, referuar ligjit ai ka të drejtën të caktohet në nivel apeli. Faleminderit!

**Alban Toro:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Pro. Mendoj që i takon të shkojë në gjykatën e apelit, prandaj duhet t'i bëhet njoftimi për të zgjedhur në të drejtën e tij për të shkuar në gjykatë apeli.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Edhe unë jam pro, pavarësisht sepse kam votuar që zotit {...} nuk i ka mbaruar detyrimi për të qëndruar në Gjykatën e Lartë, por në kushtet kur tashmë, me vendimmarrjen e mëparshme kemi një vendim i cili përcakton që ky detyrim ka mbaruar, jam e detyruar të respektoj vendimin e Këshillit për këtë gjë, dhe për këtë arsye vlerësoj që sikundër kemi mbajtur qëndrimin edhe me 5 anëtarët e tjerë, t'i njoftohet e drejta për të shkuar në Gjykatën e Apelit.

**Medi Bici:** Pro. Meqenëse shumica vendosi që gjyqtari {...} nuk duhet të rrijë më në detyrë, pra kishte qëndrim të kundër me ne, jam dakord që të njoftohet dhe nëse ai paraqet kërkesë pastaj, është arsyeja e tij.

**Naureda Llagami:** Edhe unë jam dakord, me të njëjtin argument si zoti Bici.

Atëherë, në përfundim të mbledhjes u ra dakord që z. {...} do t'i bëhet njoftimi përkatës nga Këshilli lidhur me njoftimin e të drejtës për t'u caktuar në një pozicion në gjykatën e apelit.

Faleminderit, për prezencën.

Mirupafshim!

\* \* \*

(Pika 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**